


SEMESTRI I I DYTE

VIRTYTET E TË DËRGUARIT ﷺ



HYRJJE

Personaliteti i Muhamedit ﷺ jeta dhe vepra e tij, që tek muslimanët janë bazë e vizionit Islam për botën, kanë nevojë për promovim më të gjerë. Për këtë njeri i cili ndryshoi rrjedhën e historisë, që udhëzoi një popull të lajthitur dhe që edhe sot vazhdon të ndikoj në jetën e shumë njerëzve, duhet të flitet. Këto hadithe janë bazë për njërën nga temat e historisë së hershme Islame (Es-Sire En-Nebevijje), e ajo është *esh-Shemail* - përshkrimi i pamjes së jashtme, sjelljes dhe moralit të Pejgamberit ﷺ.

Njëri nga komentuesit e shumë të këtij libri Abdur- Reuf El Munavi thotë: "Ky libër është i veçuar në lëmin e tij, dallohet për nga përfshirja e plotë e haditheve që flasin për këtë temë dhe nga radhitja tyre. Askush nuk ka përpiluar libër të ngjashëm. Gjatë përpilimit autori ndjek një metodë të jashtëzakonshme duke e zbukuruar me hadithe në mënyrë artistike, ashtu që ky libër me të drejtë konsiderohet prej dhuntive hyjnore. Ky libër u përhap në lindje dhe perëndim..." Muhamed Nasiruddin Albani thotë: "Shpresoj se ky libër do të bëhet udhëzues për muslimanët nëpërmjet të cilit ata do t'i njohin virtytet e larta të Pejgamberit ﷺ, si dhe do t'i motivojë që ta ndjekin rrugën e tij, duke zbukuruar veten me moralin e tij në këtë kohë kur shumë njerëz e kanë harruar porosinë e të Lartësuarit i cili thotë: *"Ju e kishit shembullin më të lartë në të Dërguarin e Allahut, për atë që shpreson Allahun dhe botën tjetër dhe përmend shpesh Allahun"*. (El Ahzabë, 21).

Botimi që gjendet në duart e juaja është përkthim i versionit të shkurtuar të këtij libri me vlerësimet për vërtetësinë e haditheve të dijetarit të njohur shqiptar Nasiruddin Albani i cili botoi këtë libër duke e shkurtuar atë dhe duke dhënë vlerësimin e tij për çdo hadith në bazë të parimeve të shkencës së hadithit.

Nga veçoritë e këtij botimi është edhe tubimi i gjitha transmetimeve në një vend dhe pastaj vlerësimi i hadithit, ngase pa këtë nuk do mundej të vlerësohet hadithi në mënyrë të duhur.¹

Për këtë libër janë përzgjedhur vetëm hadithet që Shejh Albani i ka cilësuar si *Sahih* apo *Hasen* dhe nuk ka hadithe që janë cilësuar si *Daif*. Janë zgjedhur një pjesë e haditheve të botimit të njohur me qëllim që ti përshtatet plan programit të Institutit.

¹ Pjesë nga hyrja e librit Virtytet e të Dërguarit të botuar nga shtëpia botuese Nun-Shkup. Tekstet e haditheve të këtij libri janë marrë nga versioni PDF i këtij libri, i veçantë për Institutin Islam Ikra, me përmirësime të përkthimit nga gjuha arabe nga stafi i institutit tanë dhe ndryshime të cilat janë bërë për dobinë e nxënësit.

SI DUKEJ I DËRGUARI ﷺ

Hadithi 1

Enes ibn Maliku, radijallahu anhu tregonte: “*i Dërguari i Allahut ﷺ nuk ishte tepër lartë, e as i shkurtë, as dukshëm i bardhë e as zeshkan, nuk kishte as flokë kaçurrela e as të drejta. Allahu e dërgoi kur i plotësoi dyzet vjet. Në Mekke kaloi dhjetë vjet, kurse në Medine dhjetë vjet. Vdiq kur i pati gjashtëdhjetë vjet, kurse flokët dhe mjekra e tij nuk kishin as njëzet qime të thinjura.*” (Transmetojnë Buhari, Muslim dhe Tirmidhi)

Transmetuesi:

Enes ibn Malik ibn En-Nadr El-Ensari El-Khazrexhi En-Nexhxhari. Shërbetori i të Dërguarit të Allahut ﷺ. Ka transmetuar nga i Dërguari i Allahut ﷺ 2286 hadithe. Ka ndërruar jetë në vitin 93 h. dhe është i fundit që ka ndërruar jetë prej sahabëve.

Shpjegimi:

- “*...nuk ishte tepër lartë e as i shkurtë...*” Nuk ishte as shumë i lartë në shtat e as i shkurtë, por anonte nga lartësia. Sepse në hadith përmendet bashkë me cilësinë e gjatësisë dhe fjala “البائن” që do të thotë: “dukshëm”. Ndërsa në anën tjetër me cilësinë e shkurtësisë nuk përmendet fjala “البائن”, që do të thotë se shtati i të Dërguarit ﷺ nuk i afrohej shkurtësisë, por i afrohej lartësisë.
- “*...as dukshëm i bardhë e as zeshkan...*” Siç është cekur në disa transmetime ngjyra e lëkurës së të Dërguarit ﷺ, nuk është krejtësisht e bardhë e as ezmer, por e bardhë shumë pak e përzier me të kuqe.
- “*...nuk kishte as flokë kaçurrela e as të drejta.*” Pra të valëzuara.

Hadithi 2

Enes ibn Maliku, radijallahu anhu, tregonte: “i Dërguari i Allahut ﷺ kishte shtat të mesëm, nuk ishte as i lartë e as i shkurtë, me shtat të bukur. Nuk kishte as flokë kaçurrela e as të drejta, ishte zeshkan, kur ecte shpejtonte.” (Transmetojnë Buhari, Muslim dhe Nesai)

Transmetuesi:

Enes ibn Malik: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

- “...*me shtat të bukur.*” Allahu i Madhëruar i ka dhuruar të Dërguarit të Tij shtat të mesëm dhe të bukur, e ka krijuar në formën më të përsosur. Të gjitha gjymtyrët i ka pasur të përshtatshme me njëra tjetrën.
- “...*ishte zeshkan, ...*” Humejdi veçohet me këtë shprehje në këtë pjesë të transmetimit nga Enesi radijAllahu anhu. Më i saktë është transmetimi që na transmetojnë të tjerët, se i Dërguari i Allahut ﷺ ka qenë lëkurëbardhë shumë pak në të kuqe.
- “...*kur ecte shpejtonte.*” Ky është përshkrimi e të ecurit e të Dërguarit ﷺ. Ka thënë Aliu radijAllahu anhu në lidhje me të ecurit e të Dërguarit ﷺ. “*Kur ecte, ecte shpejtë sikur zbriste kodrës.*”

Hadithi 3

El-Bera ibn Azibi, radijallahu anhu, transmeton: “i Dërguari i Allahut ﷺ kishte shtat të mesëm, ishte i gjerë mes shpatullave, flokët i binin deri në skajet e veshëve, i veshur në xhybe (hul-le) të kuqe. Asnjëherë nuk kam parë diçka më të bukur se ai.” (Transmetojnë Buhari, Muslim, Ebu Davud, Nesai dhe ibn Maxhe)

Transmetuesi:

El-Bera ibn Azib El-Ensari 72 h.

Shpjegimi:

- “...*kishte shtat të mesëm, ...*” Shtat të mesëm që anonte kah lartësia.

• “...ishte i gjerë mes shpatullave, ...” Në pjesën e sipërme të shpinës ishte i gjerë.

• “...flokët i binin deri në skajet e veshëve...” Flokët në aspektin e përshkrimit të gjatësisë së tyre kanë tre cilësi dhe emërtime në gjuhën arabe.

Këto tre cilësi kanë ardhur në transmetime për përshkrimin e flokëve të Rasulullahit ﷺ. Ato janë:

- *El-wefrah*: Gjatësia e flokëve që arin deri në skajet e veshëve.
- *El-limmeh*: Gjatësia e flokëve që kalojnë skajet e veshëve.
- *El-xhumme*: Gjatësia e flokëve që arin deri tek shpatullat ose prekin shpatullat.

• “...i veshur në xhybe (*hul-le*) të kuqe.” Emri “*hul-le*” në gjuhën arabe nuk përdoret për ndonjë veshje vetëm se kur kjo veshje përbëhet prej dy pjesëve siç është *izari* dhe *ridaja*. Pra kjo veshje ka qenë xhybe dhe ndër xhybe ka pasur një veshje tjetër.

Janë transmetuar hadithe të sakta për ndalesën e rrobave me ngjyrë të kuqe. Transmeton El-Bera ibn Azib: *Na ka ndalur i Dërguari ﷺ nga veshjet e kuqe.* (Buhariu dhe Muslimi)

Kuptimi hadithit është se rrobat që janë plotësisht me ngjyrë të kuqe dhe nuk përzihen me ndonjë ngjyrë tjetër nuk lejohen për burrat. Xhybja e të Dërguarit ﷺ siç ka ardhur në disa transmetime ka qenë e kuqe, por e përzier me vija të zeza. Pra rrobat e kuqe të cilat janë të përziera me ngjyra tjera lejohen për burrat.

• “...Asnjëherë nuk kam parë diçka më të bukur se ai.” As prej njerëzve as prej krijesave.

Hadithi 4

Ali ibn Ebi Talibi, radijallahu anhu, transmeton: “*i Dërguari i Allahut ﷺ nuk ishte as i lartë e as i shkurtë, kishte shuplaka dhe shputa të vrazhda, kokë dhe eshtra të mëdha, me vijë të gjatë të qimeve në gjoks. Kur ecte, ecte shpejtë sikur zbriste kodrës. Asnjëherë, as më parë e as më vonë, nuk kam parë dikë të ngjashëm me të.*” (Transmeton Tirmidhi në Menakib)

Transmetuesi:

Ali ibn Ebi Talib Ebu el-Hasenejn el-Kurashij el-Hashimi 40 h. I pari musliman prej fëmijëve, njëri prej dhjetëshit të cilët janë përgëzuar me Xhenet. Bartësi i

flamurit të Rasulullahit ﷺ në Bedr dhe në betejat tjera. Prijësi i katërt i drejtë i muslimanëve pas të Dërguarit të Allahut ﷺ.

Shpjegimi:

- “...kishte shuplaka dhe shputa të vrazhda...” kjo nuk do të thotë se i Dërguari i Allahut ﷺ nuk i ka pasur duart dhe këmbët e buta dhe të këndshme, sepse Enesi radijAllahu anhu thotë: “Nuk kam prekur tesha mëndafshi dhe mëndafsh e as ndonjë gjë tjetër të jetë më e butë se dora e të Dërguarit të Allahut ﷺ.

- “...kokë dhe eshtra të mëdha...” i Dërguari i Allahut ﷺ të gjitha gjymtyrët i ka pasur të përshtatshme me njëra tjetrën.

Pra kur thuhet kokë të madhe dhe eshtra të mëdha nuk duhet të kuptohet madhësia jashtë normales. Kuptohet se i Dërguari i Allahut ﷺ nuk ka qenë me trup të imtë dhe të dobët, por të fuqishëm dhe të qëndrueshëm. Nyjat e eshtrave, pra kockat i ka pasur të qëndrueshme.

Hadithi 5

Xhabir ibn Semure radijallahu anhu, tregon: “I Dërguari i Allahut ishte gojëmadh, symadh, kishte thembra të vogla.” (Transmetojnë Muslim dhe Tirmidhi)

Transmetuesi:

Xhabir ibn Semure ibn Xhundub, Ebu Khalid Es-Sivai 76 h.

Shpjegimi:

Tha Shu’beh: I thash Simak ibn Harbit: Çfarë kuptimi ka “gojëmadh”? Tha: gojë të madhe. Domethënë jo të vogël dhe të ngushtë. Thash: Çfarë kuptimi ka “symadh”? Tha: gropat e syve të gjata. Thash: Çfarë kuptimi ka “thembra të vogla.” Tha: Thembra me pak mish.

Hadithi 6

Xhabir ibn Semure, radijallahu anhu, tregon: “Një natë të ndritshme pashë të Dërguarin e Allahut ﷺ të veshur me xhybe të kuqe. Shikova atë e pastaj edhe hënën, për mua ai ishte më i bukur se hëna.” (Transmeton Tirmidhi).

Transmetuesi:

Xhabir ibn Semure: Është cekur më herët.

Shjegimi:

• “*Një natë të ndritshme...*” Nata është e ndritshme kur është hëna e plotë dhe mos të ketë re që e pengojnë dritën e hënës.

Hadithi 7

Ebu Is’haku thotë se një njeri e ka pyetur El-Bera ibn Azib radijallahu anhu: “*A ishte fytyra e Resulullahut si shpatë? Tha: Jo, por si hëna.*” (Transmetojnë Buhari, Tirmidhi dhe Ahmed)

Transmetuesi:

El-Bera ibn Azib ibn El-Harith, Ebu Imarah El-Ensari. Fekihu i madh, 72h.

Shpjegimi:

Thotë ibn Haxheri në Fet’hul Bari: “Sikur pyetësi kishte për qëllim si shpatë në gjatësi dhe ia ktheu El-Bera radijAllahu anhu dhe tha: Përkundrazi si hëna. Domethënë në rumbullakësi. Ka mundësi të ketë për qëllim si shpatë në shkëlqim dhe u përgjigj: Jo! Më shumë dhe e përngjatoi me hënën për shkak përmbajtjes së saj të dy cilësive, rumbullakësisë dhe shkëlqimit.”

Fytyra e të Dërguarit ﷺ nuk ishte në formë të rumbullakët krejtësisht, por ishte mes të rumbullakëtës dhe të gjatës.

Hadithi 8

Ebu Hurejre, radijallahu anhu, transmeton: “*I Dërguari i Allahut ﷺ ishte lëkurëbardhë sikur të ishte prej argjendi, kishte flokë si të valëzuara.*” (Transmetojnë Muslim dhe Tirmidhi)

Transmetuesi:

Ebu Hurejre, Abdurrahman ibn Sakhr El-Jemani 59h. Sahabiu që ka transmetuar më shumë hadithe (5374 hadithe) nga i Dërguari i Allahut ﷺ.

Shpjegimi:

“*...lëkurëbardhë sikur të ishte prej argjendi ...*” I Dërguari i Allahut ﷺ ishte lëkurëbardhë shumë pak të përzier në të kuqe.

VULA E PEJGAMBERISË

Hadithi 9

Saib ibn Jezidi, radijallahu anhu, tregon: “*Më morri tezja ime tek i Dërguari i Allahut ﷺ dhe i tha: - O i Dërguari i Allahut, djali i motrës time është i sëmurë! I Dërguari i Allahut ma ledhatoi kokën, luti Allahun të më bekojë e pastaj mori abdes. Unë piva nga uji i abdesit, qëndrova pas tij dhe fillova t'ia shikoj vulën e pejgamberisë që e kishte ndërmjet shpatullave, që ishte sa një vezë shkurtëze.*” (Transmetojnë Buhari, Muslim dhe Tirmidhi)

Transmetuesi:

Saib ibn Jezidi 91h. Sahabiu i fundit që ka ndërruar jetë në Medine, në moshën 96 vjeçare.

Shpjegimi:

- “*...ma ledhatoi kokën...*” Në këtë vepër të Dërguarit të Allahut ﷺ shohim mëshirë për të sëmurin, që ishte edhe i vogël në moshë. Por, gjithashtu vendosja e dorës tek i sëmuri tregon se prej çfarë vuan i sëmuri, vërehet temperatura, rrahja e zemrës etj.
- “*...luti Allahun të më bekojë...*” Saibi radijAllahu anhu ka pasur një jetë shumë të begatshme dhe të shëndetshme, për shkak lutjes së Pejgamberit ﷺ.
- “*...mori abdes. Unë piva nga uji i abdesit...*” Kërkimi i bereqetit me të Dërguarin e Allahut ﷺ është prej veçorive të Dërguarit ﷺ.
- “*...fillova t'ia shikoj vulën e pejgamberisë që e kishte ndërmjet shpatullave, që ishte sa një vezë shkurtëze.*” Këtu kuptojmë vendin e vulës së pejgamberisë në trupin e Pejgamberit ﷺ dhe madhësinë e saj.

Hadithi 10

Xhabir ibn Semure tregon: “*E pash vulën e pejgamberisë ndërmjet dy shpatullave, dukej si gjëndër e kuqe në madhësi të vezës së pëllumbeshës.*” (Transmetojnë Muslim dhe Tirmidhi)

Transmetuesi:

Xhabir ibn Semure: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

- “...ndërmjet dy shpatullave...” Sipas disa transmetimeve vula e peygamberisë ishte ndërmjet dy shpatullave të Dërguarit ﷺ dhe anonte nga ana e majtë në drejtim të zemrës.
- “...dukej si gjëndër e kuqe në madhësi të vezës së pëllumbeshës.” Këtu kuptojmë tre cilësi të vulës së peygamberisë, ato janë: Forma, ngjyra dhe madhësia.

Hadithi 11

Ebu Zejd Amër ibn Ahtab El-Ensari, radijallahu anhu, transmeton: “*Me një rast i Dërguari i Allahut ﷺ më tha: O Ebu Zejd, afrohu dhe fërkoma shpinën time dhe ia fërkova shpinën dhe gishtat e mi prekën vulën (e peygamberisë). E pyeta: - Si ishte vula? - Disa qime të mbledhura, u përgjigj.*” (Transmetojnë Ahmed, ibn Sa’d, ibn Hibban dhe Hakim)

Transmetuesi:

Ebu Zejd Amër ibn Ahtab El-Ensari. Ka ndërruar jetë në kohën e Abdulmelik ibn Mervanit.

Shpjegimi:

- “*Disa qime të mbledhura...*” Kjo cilësi është ajo që e ka vërejtur Amër ibn Ahtabi me dorën e tij kur e ka fërkuar shpinën e Rasulullahit ﷺ. Kjo gjë nuk do të thotë se vula e peygamberisë ka qenë vetëm disa qime të mbledhura. Ka qenë si një gungë në madhësinë e vezës së pëllumbeshës e rrethuar me qime. Pra ky transmetim nuk i kundërshton transmetimet e kaluara.

Hadithi 12

Ebu Se’id el-Khudri, radijallahu anhu, tha për vulën e Peygamberit ﷺ, d.m.th. për vulën e peygamberisë: “*Vula e peygamberisë ishte në shpinën e tij copë mishi, e dalluar (si gungë).*” (Transmeton Tirmidhi)

Transmetuesi:

Ebu Se'id el-Khudri Sa'd ibn Malik el-Khazrexhi el-Ensari 74h.

Shpjegimi:

- “...copë mishi, e dalluar” Gjëndër si copë mishi, dallohej në shpinën e të Dërguarit ﷺ, pra e ngritur nga pjesa tjetër e shpinës dhe në madhësinë e vezës së pëllumbeshës siç është cekur edhe më herët.

Hadithi 13

Abdullah ibn Serxhisi, radijallahu anhu, tregon: “Me një rast erdha tek i Dërguari i Allahut ﷺ derisa rrinte ulur me as'habët dhe unë kështu (dhe e tregoi mënyrën) i shkova pas shpine. Ai hetoi qëllimin tim dhe largoi pelerinën që kishte mbi supet. Atëherë e pashë vulën e peygamberisë ndërmjet shpatullave, dukej si grusht i mbledhur rreth të cilit ishin pikëza të zeza si çibanë. Pastaj u ngrita përpara tij dhe i thashë: Allahu të faltë, o i Dërguari i Allahut! Tha: Edhe ty. - A kërkoi i Dërguari i Allahut falje për ty? - e pyetën të pranishmit Abdullahun. -Po, edhe për ju ka kërkuar falje. Dhe Abdullahu lexoi ajetin: ‘...kërko falje për mëkatin tënd, për të besimtarëve e të besimtareve...’ (Muhamed: 19)” (Transmetojnë Muslim dhe Ahmed)

Transmetuesi:

Abdullah ibn Serxhisi el-Muzeni ka ndërruar jetë pas vitit 80 hixhri në Basra.

Shpjegimi:

- “...pikëza të zeza si çibanë.” Këtu shohim edhe një cilësi të vulës së peygamberisë përpos atyre që janë përmendur më herët. Mund të përshkruhet se rreth vulës së peygamberisë ka pasur nishane si njolla me ngjyrë të zezë.

FLOKËT E TË DËRGUARIT

Hadithi 14

Enes ibn Maliku, radijAllahu anhu, transmeton: “*Flokët e të Dërguarit të Allahut ﷺ ishin deri në mes të veshëve.*” (Transmetojnë Muslim, Ebu Davud, Nesai dhe ibn Maxhe)

Transmetuesi:

Enes ibn Malik: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

Ky hadith na tregon se flokët e të Dërguarit ﷺ ishin deri në mes të veshëve. Janë transmetuar disa hadithe që tregojnë se i ka pasur flokët e gjata deri te shpatullat (xhummeh).

Kanë thënë disa prej dijetarëve: Dallimi në mes transmetimeve është në bazë të dallimit të gjendjes, ai transmetues i cili e ka parë të Dërguarin ﷺ me flokë të gjata deri tek shpatullat, ka transmetuar se flokët e tij kanë qenë *xhummeh*. Dhe ai që e ka parë kur flokët e tij ishin më të shkurta, i ka cilësuar me atë gjendje që e ka parë të Dërguarin ﷺ. Pra nuk ka kontradiktë mes transmetimeve.

Hadithi 15

Aishja, radijallahu anha, transmeton: “*Lahesha me të Dërguarin e Allahut ﷺ prej një ene, kurse flokët e tij nuk ishin as xhummeh e as wefrah.*” (Transmetojnë Tirmidhi, Ebu Davud dhe ibn Maxhe)

Transmetuesja:

Aishe bint Ebi Bekr es-Siddik (Allahu qoftë i kënaqur me ta). Nëna e besimtarëve, bashkëshortja e të Dërguarit të Allahut ﷺ. Ka transmetuar nga i Dërguari ﷺ 2210 hadithe. Gruaja më fekihe e ummetit. Ka ndërruar jetë në vitin 58 të hixhretit.

Shpjegimi:

- “*Lahesha me të Dërguarin e Allahut ﷺ prej një ene, ...*” Ky është argumenti se bashkëshorti me bashkëshorten lejohet të lahen prej një enë.
- “*... kurse flokët e tij nuk ishin as xhummeh e as wefrah.*” Flokët e të Dërguarit ﷺ në këtë rast në aspektin e gjatësisë binin ndër vesh por nuk arrinin deri tek shpatullat, domethënë ishin në mesatari që përshkruhet me fjalën “limmeh” në gjuhën arabe.

Hadithi 16

Ummu Hani, radijAllahu anha, tregon: “*Kur i Dërguari i Allahut ﷺ e çliroi Mekken, hyri në të ndërsa flokët i kishte të gërshetuar në katër gërshetë.*” (Transmetojnë Tirmidhi, Ebu Davud, ibn Maxhe dhe Ahmed)

Transmetuesja:

Ummu Hani bint Ebi Talib. Fakhite ose Hind. Ka ndërruar jetë pas vitit 50h.

Hadithi 17

Ibn Abbasi, radijAllahu anhu, tregon: “*I Dërguari i Allahut ﷺ kishte flokë të gjata të cilat i lëshonte. Mushrikët u bënë vijë flokëve në mes të kokës, kurse ithtarët e Librit (çifutët dhe krishterët) i lëshonin flokët, ndërsa i Dërguari ﷺ pëlqente përputhjen me ithtarët e Librit në gjërat për të cilat nuk kishte urdhër të prerë, kurse më vonë filloi ti ndaj flokët.*” (Transmetojnë Buhari, Muslim, Ebu Davud, Nesai, ibn Maxhe dhe Ahmed)

Transmetuesi:

Ibn Abbasi: Abdullah ibn Abbas ibn Abdilmuttalib 68h. Ka transmetuar nga i Dërguari ﷺ 1660 hadithe.

Shpjegimi:

- “*... i lëshonte.*” Flokët e gjata i lëshonte pas kokës lirshëm pa u bërë vijë.
- “*... Mushrikët u bënë vijë flokëve në mes të kokës...*” I ndanin flokët në mes të kokës përgjysmë, në të djathtë dhe në të majtë.

- “... pëlqente përputhjen me ithtarët e librit në gjërat për të cilat nuk kishte urdhër të prerë, ...” Pëlqente praktikën e veprave të tyre, në gjërat që nuk kishte urdhër të prerë, sepse ithtarët e librit kishin libra të zbritur nga Allahu dhe kishte mundësi t’ia qëllonin të vërtetës, për dallim nga idhujtarët, të cilët veprat i kishin sipas dëshirave dhe pasioneve të tyre.
- “... kurse më vonë filloi ti ndaj flokët.” Thotë ibn Haxheri: Ndarja e flokëve përgjysmë ishte praktika e fundit prej dy llojeve të mbajtjes së flokëve të të Dërguarit ﷺ.

SI I KRIHTE FLOKËT

Hadithi 18

Aishja, radijAllahu anha, tregon: “Të Dërguarit të Allahut ﷺ i pëlqente të fillojë nga ana e djathtë: gjatë pastrimit, gjatë krehjes së flokëve dhe gjatë mbathjes.” (Transmetojnë Buhari, Muslim, Ebu Davud dhe ibn Maxhe)

Transmetuesja:

Aishe radijAllahu anha: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

Imam Buhariu (Allahu e mëshiroftë) e transmeton këtë hadith në Sahihun e tij dhe në fund shton: “...dhe në të gjitha punët e tij.”. Pra i pëlqente të fillojë nga ana e djathtë në të gjitha punët.

- “...i pëlqente të fillojë nga ana e djathtë...” Të Dërguari të Allahut ﷺ, në çdo punë të hajrit dhe të ndershme, i pëlqente të fillojë nga ana e djathtë, ose të përdorë gjymtyrën e djathtë. Edhe në krehjen e flokëve fillonte ti krihte flokët që ishin në anën e djathtë të kokës.

Hadithi 19

Abdullah ibn Mugaffel, radijallahu anhu, tregon se i Dërguari i Allahut ﷺ ka ndaluar krehjen e flokëve përpos se rrallë. (Transmetojnë Ebu Davud, Nesai dhe ibn Hibban)

Transmetuesi:

Abdullah ibn Mugaffel 60h. Është nga sahabet të cilët ja kanë dhënë besën “Er-Riduan” të Dërguarit ﷺ.

Shpjegimi:

- “...ka ndaluar krehjen e flokëve përpos se rallë.” Si në çdo çështje edhe në këtë çështje i Dërguari i Allahut ﷺ pasonte mesatarinë dhe udhëzonte në të. Nuk e harxhonte kohën përtej normales për krehjen dhe mirëmbajtjen e flokëve, por edhe nuk i linte flokët pa krehur dhe pa mirëmbajtje.

QIMET E THINJURA

Hadithi 20

Enes ibn Maliku, radijallahu anhu, tregon: “*Nuk kam numëruar në flokët dhe mjekrën e të Dërguarit ﷺ më shumë se katërbëdhjetë qime të bardha.*” (Transmetojnë Buhari dhe ibn Maxhe)

Transmetuesi:

Enes ibn Malik: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

Enesi radijAllahu anhu në këtë hadith na tregon se qimet e thinjura në flokët dhe mjekrën e të Dërguarit ﷺ kanë qenë shumë pak. Aq pak sa që sahabet kishin mundësi ti numëronin, pra vetëm katërbëdhjetë qime.

Buhariu dhe Muslimi transmetojnë nga hadithi Enesit radijAllahu anhu: “*Allahu ia morri shpirtin të Dërguarit ﷺ, ndërsa në flokët dhe mjekrën e tij nuk kishte as njëzet qime të thinjura.*”

Hadithi 21

Xhabir ibn Semure, radijallahu anhu, është pyetur: *A kishte në kokën e të Dërguarit ﷺ thinja? Tha: Nuk kishte thinja në kokën e të Dërguarit të Allahut ﷻ, përveç disa qimeve në ndarjen e flokëve të Dërguarit ﷺ të cilat i fshihje vaji kur lyente flokët me të.*” (Transmetojnë Muslim dhe Nesai)

Transmetuesi:

Xhabir ibn Semure: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

Xhabiri radijAllahu anhu tregon se thinjat në flokët e të Dërguarit ﷺ ishin në vendin ku i ndante flokët përgjysmë, pra në mes të kokës. Këto thinja në sasi shumë të vogël nuk dukeshin kur i Dërguari ﷺ i lyente flokët me vaj ulliri ose siç është transmetuar në disa transmetime se i ka lyer me misk (parfum). Ndërsa kur nuk i lyente flokët atëherë vëreheshin këto thinja.

Hadithi 22

Ibn Abbasi, radijallahu anhu, tregon: *“Me një rast pyeti Ebu Bekri: O i Dërguari i Allahut, shoh se je thinjur? Më thinjën suret Hud, El-Vakia, El-Murselat, Amme jetesaelun dhe Idhesh-shemsu kuvvirat.”* (Transmeton Tirmidhi dhe Hakim)

Transmetuesi:

Ibn Abbasi: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

- *“Me një rast pyeti Ebu Bekri: O i Dërguari i Allahut, shoh se je thinjur?”* Qëllimi i pyetjes së Ebu Bekrit radijAllahu anhu është se për çfarë shkak je thinjur o i Dërguari i Allahut?
- *“Më thinjën suret Hud, El-Vakia, El-Murselat, Amme jetesaelun dhe Idhesh-shemsu kuvvirat.”* Sepse në këto sure të Kuranit përmenden gjendjet e vështira, brengat dhe frika e Ditës së Gjykimit. Brenga e të Dërguarit ﷺ ka qenë llogaria që do jepet para Allahut ﷻ e jo çështjet e kësaj bote.

KËNAJA

Hadithi 23

Uthman ibn Meuheb tregon: “Është pyetur Ebu Hurejra, radijallahu anhu, a është lyer i Dërguari i Allahut me këna, u përgjigj: “Po”. (Transmetojnë Buhari, Ahmed dhe ibn Maxhe)

Transmetuesi:

Ebu Hurejra: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

- “...a është lyer i Dërguari i Allahut me këna, u përgjigj: “Po”. Ngjyerja me këna është një proces i ndryshimit të ngjyrës së qimeve të thinjura me këna dhe *El-Ketem*, ose vetëm me këna.

Kënaja: Bojë e kuqërreme, e cila nxirret nga përpunimi i gjetheve të thara të një druri të vogël, që rritet në ranishtet e Afrikës dhe të Gadishullit Arabik.

El-Ketemu: Një lloj druri që përdoret për ngjyerje, që u jep qimeve ngjyrë të zezë.

Sahabet radijAllahu anhum kanë mendime të ndryshme në çështjen se a i ka ngjyer i Dërguari ﷺ flokët dhe mjekrën me këna apo jo?

Ka thënë ibnul Kajjimi në librin e tij *Zadul Mead*: “Enesi radijAllahu anhu ka thënë: Nuk është lyer me këna. Ebu Hurejre radijAllahu anhu ka thënë: Është lyer me këna. Një grup kanë thënë: I Dërguari ﷺ e lyente kokën me parfum aq shumë sa që i skuqeshin flokët dhe disa mendonin se ishte lyer me këna, por ai nuk a lyer në realitet”.

Hadithi 24

Enes ibn Maliku, radijallahu anhu, tregon: “I pash flokët e të Dërguarit ﷺ të lyera me këna.” (Transmeton Tirmidhi)

Transmetuesi:

Enes ibn Malik: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi nga Katade e ai tha: E pyeta Enes ibn Malik radijallahu anhu: A i ka lyer flokët me këna i Dërguari i Allahut ﷺ? - Nuk ka pasur nevojë, kishte disa qime të bardha te tëmblat (zylyfet), por Ebu Bekri radijallahu anhu i lyente flokët me këna dhe ketem. Dhe mendimi Imam Tirmidhiut është se i Dërguari i Allahut ﷺ nuk i ka lyer flokët me këna.

SYRMEJA**Hadithi 25**

Ibn Abbasi, radijallahu anhu, tregon se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “*Tërhiqni syrmen me ithmid (antimon), sepse ai mpreh shikimin dhe forcon qerpikët.*” (Transmetojnë ibn Maxhe dhe Nesai dhe hadithi i njëjtë është transmetuar prej Xhabirit, ibn Abbasit dhe ibn Omerit, radijallahu anhum)

Transmetuesi:

Ibn Abbasi: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

- “*Tërhiqni syrmen me ithmid, ...*” Syrmeja është prej udhëzimit të të Dërguarit të Allahut ﷺ. Ai e ka praktikuar vet dhe ka këshilluar që të praktikohet.

Syrmeja (el-Kuhlu): Është një lloj guri prej të cilit ka me ngjyrë të zezë dhe që anon në ngjyrë të kuqe dhe këtyre dyve u thuhet *ithmid*. *Ithmidi* copëtohet shumë lehtë dhe bluhet krejtësisht derisa të bëhet shumë i imtë, si pluhur, pastaj me një mjet (miil, mekhal) vendoset (tërhiqet) në sy. I Dërguari ﷺ ka këshilluar që syrmeja të tërhiqet me *ithmid*.

- “*... sepse ai mpreh shikimin dhe forcon qerpikët.*” I Dërguari ﷺ në këtë hadith përmend dy dobitë e tërheqjes së syrmes me *ithmid*:

1. “*Mpreh shikimin*” Është përmirësues, pastrues dhe dëlirës për syrin dhe ndihmon pozitivisht në qartësinë e shikimit.
2. “*Forcon qerpikët.*” Bën që të forcohen dhe të mbinë qerpikët. Qerpikët janë mbrojtje për syrin nga pluhuri, rëra dhe rreziqet tjera të jashtme që mund të dëmtojnë syrin si dhe janë zbukurim për syrin.

VESHJA E TË DËRGUARIT ﷺ

Hadithi 26

Ummu Seleme, radijallahu anhu, tregonte: “*Veshja më e dashur e të Dërguarit të Allahut ishte kamisi.*” (Transmetojnë Ebu Davud, Tirmidhi dhe Nesai)

Transmetuesja:

Ummu Seleme, Hind Bint Ebi Umejje 61h. Nëna e besimtarëve, bashkëshortja e të Dërguarit ﷺ. Ka transmetuar nga i Dërguari ﷺ 378 hadithe. Konsiderohet prej sahabeshave fekihe. Gruaja e fundit e të Dërguarit ﷺ që ka ndërruar jetë.

Shpjegimi:

- “*Veshja më e dashur e të Dërguarit të Allahut ishte kamisi.*” Kamisi është veshje për burra, një këmishë e gjatë që e mbulon tërë trupin. Njihet dhe me emrin *galebije*. I Dërguari ﷺ e donte kamisin, sepse është e lehtë për tu veshur dhe për tu zhveshur. Njëkohësisht lëvizja në të është shumë më lehtë sesa veshjet tjera sikurse *izari* p.sh.

Hadithi 27

Ebu Se’id Khudriu, radijallahu anhu, tregon: “*I Dërguari i Allahut kur vishte rrobe të reja, qoftë imame, Kamis apo rida, i emërtonte dhe thoshte: "O Allahu im! Ty të takon falënderimi që më veshe me këtë veshje (dhe e përmendte me emër). Të lutem për të mirën e saj dhe për të mirën për çka është qepur, kurse mbështetem te Ti nga e keqja e saj dhe e keqja për çka është qepur.*” (Transmetojnë Ebu Davud, Nesai dhe Tirmidhi)

Transmetuesi:

Ebu Se'id Khudriu: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

Në këtë hadith është lutja e veshjes së rrobave të reja dhe është prej sunetit të Dërguarit ﷺ kur Allahu ﷻ e furnizon dikë me rroba të reja ta bëjë këtë lutje gjatë veshjes së tyre.

- *“O Allahu im! Ty të takon falënderimi që më veshe me këtë veshje.”* Fillon lutjen me falënderim ndaj Allahut subhanehu ue teala i cili e dhuron këtë begati. Të qenët mirënjohës ndaj tij për këtë veshje, e cila është mbulesë për trupin e njeriut, e mbulon *auretin* (vendet e turpshme), është zbukurim për të dhe njëkohësisht mbrojtje nga ftohti dhe vapa. Padyshim kjo begati e madhe është prej mirësive të Allahut subhanehu ue teala për njerëzit. Thotë Allahu në Kuran: *“O bijtë e Ademit, Ne krijuam për ju petk që ju mbulon vendet e turpër dhe petk zbukurues. Po petku i devotshmërisë, ai është më i miri. Këto janë argumentet e Allahut, ashtu që ata të përkujtojnë.* (Sureja El A'raf – 26)
- *“Të lutem për të mirën e saj dhe për të mirën për çka është qepur...”* Për të mirën e kësaj veshje. Mirësitë e veshjes janë të shumta dhe i Dërguari ﷺ i lyp prej Allahut krejt mirësitë e veshjes.
- *“...kurse mbështetem te Ti nga e keqja e saj dhe e keqja për çka është qepur.”* Kërkoj mbrojtje prej teje o Allah nga e keqja e kësaj veshje. Dhe të këqijat e disa veshjeve mund të jenë të shumta, p.sh: të vesh dikush ndonjë veshje për tu dalluar prej të tjerëve, mburrja, mendjemadhësia, veshjet me fotografi të ndaluara, veshjet e ngushta të cilat e bëjnë të dalluar auresin (pjesët e turpshme) etja.

Hadithi 28

Enes ibn Maliku, radijallahu anhu, na tregon: *“Veshja më e dashur e të Dërguarit të Allahut ﷺ që vishte ishte el-hiberatu.”* (Transmetojnë Buhari dhe Muslim)

Transmetuesi:

Enes ibn Malik: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

- “...*el-hiberatu*.” Me këtë është përqëllim xhybeja e Jemenit.

El-Hiberatu: Rroba që prodhohen prej pambukut dhe janë të zbukuruar me vija në ngjyrë të ndryshme. Xhybeja e Jemenit ka qenë e kuqe me vija të zeza.

Hadithi 29

Ebu Xhuhejfe, radijallahu anhu, tregon: “*Pashë të Dërguarin e Allahut të veshur me xhybe të kuqe, sikur tani jam duke e parë shkëlqimin e dy kërcinjve të tij. Sufjani, njëri prej transmetuesve, thotë: Mendoj se është el-hiberatu.*” (Transmeton Buhari)

Transmetuesi:

Ebu Xhuhejfe: Vehb ibn Abdullah el-Kufij 74h. Prej sahabëve të vegjël.

Shpjegimi:

- “*Pashë të Dërguarin e Allahut të veshur me xhybe të kuqe...*” Kjo xhybe është xhybeja e Jemenit siç e ka përmendur edhe Sufjan eTh-theuri. Nuk ka qenë krejtësisht në ngjyrë të kuqe, por e përzier me vija të zeza, sepse rrobat që janë plotësisht në ngjyrë të kuqe ndalohen për burrat musliman siç e kemi përmendur edhe më herët.

- “*...sikur tani jam duke e parë shkëlqimin e dy kërcinjve të tij.*” Kemi kuptuar nga hadithet e kaluar se trupi i të Dërguarit të Allahut ﷺ ka shkëlqyer si hëna. Edhe këtu Ebu Xhuhejfe tregon se si shkëlqente kërciri i të Dërguarit të Allahut ﷺ.

Këtu kuptojmë se veshja e të Dërguarit ﷺ e ka pasur gjatësinë deri në mes të kërcirit.

Hadithi 30

Ibn Abbasi, radijallahu anhu, transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “*Ju porosis për rroba të bardha. Le ti veshin të gjallët tuaj dhe me to mbështillni të vdekurit tuaj, sepse ato janë prej rrobave më të mira.*” (Transmetojnë Ebu Davud, Tirmidhi dhe ibn Maxhe)

Transmetuesi:

Ibn Abbasi: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

Në këtë hadith i Dërguari ﷺ na inkurajon të veshim rroba të bardha dhe ti mbështjellim të vdekurit tanë me qefin të bardh.

Urtësia që na nxit i Dërguari ﷺ për veshje në ngjyrë të bardhë është se me një hadith tjetër i Dërguari ﷺ thotë: “*Vishni rroba të bardha, me të vërtetë ato janë më të pastra dhe më të bukura (mira)...*” (Transmeton Tirmidhiu në *el-Xhami’a* 2810)

Rrobat e bardha kanë dy cilësi; pastërtinë dhe bukurinë.

Rrobat e bardha kur lahen dhe pastrohen dallohen me bukuri, shkëlqim dhe dëlirësi. Nëse njollosen apo gjendet në to ndonjë papastërti, menjëherë vërehet dhe detyron personin që të pastrohet dhe të qëndrojë gjithmonë i pastër. Kështu që edhe pse lejohen ngjyrat tjera në veshje, në bazë të argumenteve themi se rrobat e bardha janë më të pastra dhe më të bukura.

Hadithi 31

Mugire ibn Shu’be, radijallahu anhu, tregon: “*I Dërguari i Allahu ﷺ me një rast veshi një xhybe bizantine me mëngë të ngushta.*” (Transmetojnë Buhari dhe Muslim)

Transmetuesi:

Mugire ibn Shu’be eth-Thekafij 50h. Prej sahabëve të mëdhej. Njihej si trim dhe strateg.

Shpjegimi:

• “*...xhybe bizantine...*” Xhybe është lloj i veshjes që vishet mbi *kamis* dhe kjo xhybe që përmendet në këtë hadith është prej xhybeve të bizantinëve.

Çdo veshje që nuk i kundërshton dispozitat e fesë së Allahut subhanehu ue teala është e lejuar. Thotë Allahu i Madhëruar: “***Thuaj: “Kush i ndaloi bukuritë dhe ushqimet e mira që Allahu i nxori për robërit e Tij...?”*** (Surja *El-E’araf*-32)

MESTET E TË DËRGUARIT

Hadithi 32

Burejde, radijallahu anhu, tregon: “*Nexhashiu i dhuroi të Dërguarit të Allahut ﷺ meste të zeza dhe pa zbukurime, i mbathi, mori abdes dhe u dha mes’h.*” (Transmetojnë Ebu Davud, Tirmidhi dhe ibn Maxhe)

Transmetuesi:

Burejde ibn El-Hasib Ebu Abdullah 62h.

Shpjegimi:

- “*Nexhashiu i dhuroi të Dërguarit të Allahut ﷺ meste...*” En-Nexhashi është titull që përdoret për mbretërit e Abisinisë. Ky mbreti që i ka dhuruar të Dërguarit ﷺ meste e ka patur emrin Es’hame. Pranoi Islamin dhe vdiq musliman. I Dërguari ﷺ ia fali namazin e xhenazes (salatul gaib) prej në Medine.

Mestet prodhohen prej lëkurës, mbathen në këmbë dhe i mbulojnë ato deri mbi nyje.

- “*...e ai i mbathi...*” I Dërguari ﷺ menjëherë i mbathi ato, gjë që tregon për mirënjohjen e të Dërguarit ﷺ për dhuratën e bërë. Pranimi i dhuratave është prej udhëzimit të Dërguarit ﷺ, sepse pranimi i tyre e gëzon dhuruesin.
- “*...mori abdes dhe u dha mes’h.*” Në çështjen e mes’hut mbi meste janë transmetuar hadithe të shumta të sakta (tevaturo) nga i Dërguari ﷺ.

MBATHJET E TË DËRGUARIT

Hadithi 33

Ibn Abbasi, radijallahu anhu, tregon: “*I Dërguari i Allahut ﷺ kishte mbathje me dy rripa të kthyer.*” (Transmeton ibn Maxhe)

Transmetuesi:

Ibn Abbasi: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

- “*...kishte mbathje me dy rripa të kthyer.*” Këpucët apo sandalet e të Dërguarit ﷺ në pjesën e sipërme të këmbës kishin dy rripa. Tek këto rripa lidhet edhe një rrip i cili kalon mes gishtërinjve dhe lehtëson ecjen dhe qëndrimin e mbathjes në këmbë.

Hadithi 34

Isa ibn Tahmani, rahimehullah, tregon: *Enesi, radijallahu anhu, nxori para neve sandale prej lëkurës së regjur (pa qime) me dy rripa. Më vonë Thabiti më tha, ata ishin sandalet e të Dërguarit, ﷺ.* (Transmetojnë Buhari dhe ibn Maxhe)

Hadithi 35

Ebu Hurejre, radijallahu anhu, transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “*Kur të mbathni, mbathni këmbën e djathtë, kurse kur të zbathni së pari zbathni të majtën. Këmba e djathtë le të jetë e para që mbathet, kurse e fundit që zbathet.*” (Transmetojnë Buhari, Muslimi, Ebu Davud, Tirmidhi dhe ibn Maxhe)

Transmetuesi:

Ebu Hurejre: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

Në këtë hadith mësojmë se këmba e djathtë ka përparësi mbi të majtën në mbathje. Prej udhëzimit të Dërguarit ﷺ ishte dhënia përparësi anës së djathtë në punët e ndershme, si krehja e flokëve, mbathja, abdesi, hyrja në xhami etj.

Dhe dhënia përparësi të majtës në veprat e kundërta, si z bathja e këpucëve, hyrja në nevojto re, dalja nga xhamia etj.

UNAZA E TË DËRGUARIT

Hadithi 36

Enes ibn Maliku, radijallahu anhu, tregon: “*Unaza e të Dërguarit ﷺ ishte prej argjendi, kurse guri i saj nga Abisinia.*” (Transmetojnë Buhari, Muslimi, Ebu Davud, ibn Maxhe, Tirmidhi dhe Nesai)

Transmetuesi:

Enes ibn Maliku: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

- “*...ishte prej argjendi, ...*” Ky është argument që për burrin musliman lejohet përdorimi i unazës së argjendit.
- “*...kurse guri i saj nga Abisinia.*” Ose guri ishte nga Abisinia, ose mënyra e gdhendjes apo punimit ishte si punimet e Abisinisë.

Hadithi 36

Enes ibn Maliku, radijallahu anhu, tregon: “I Dërguari ﷺ u shkroi (dërgoi) Kisra-së, Cezarit dhe Nexhashi-ut dhe iu tha: - Ata (perandorët) nuk pranojnë letra pa vulë. Atëherë ai bëri unazë, rrethi i së cilës ishte prej argjendit në të cilën ishte i gdhendur: Muhamedun resulullah.” (Transmetojnë Buhari, Muslim, Tirmidhi, Nesai dhe Ebu Davud)

Transmetuesi:

Enes ibn Malik: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

- “...ishte i gdhendur: Muhamedun resulullah.” Në reshtin e parë; Muhamed, në reshtin e dytë; Resul, në reshtin e tretë; Allah. Që do të thotë: “Muhamedi, i Dërguari i Allahut.”

Hadithi 37

Ibn Omeri, radijallahu anhu, tregon: “I Dërguari i Allahut ﷺ në dorën e tij mbante unazë prej argjendit, pastaj ishte në dorën e Ebu Bekrit, pastaj në dorën e Omerit dhe pastaj në dorën e Othmanit, derisa i ra nga dora në pusin Eris. Në unazë ishte gdhendur: Muhamedun Resulullah.” (Transmetojnë Buhari, Nesai dhe Ebu Davud)

Transmetuesi:

Ibn Omeri: Abdullah ibn Omer ibn Khattabi, Ebu AbduRrahman 73h. Ka transmetuar 2630 hadithe nga i Dërguari i Allahut ﷺ.

Shpjegimi:

- “...pastaj në dorën e Othmanit, derisa i ra nga dora në pusin Eris.” Pusi Eris ishte afër xhamisë së Kubasë. Pasi unaza i ra në këtë pus, Othmani radijAllahu anhu bashkë me shokët e vet e kanë kërkuar unazën tre ditë por nuk e kanë gjetur dot.

I DËRGUARI MBANTE UNAZËN NË DORËN E DJATHTË

Hadithi 39

Ali ibn Ebi Talibi, radijallahu anhu, thotë: “*I Dërguari i Allahut ﷺ unazën e mbante në dorën e djathtë.*” (Transmetojnë Ebu Davudi dhe Nesai)

Transmetuesi:

Ali ibn Ebi Talib: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

Në cilën dorë është më e pëlqyeshme të mbahet unaza?

Në këtë çështje kemi transmetime të ndryshme se i Dërguari ﷺ mbante unazën si në dorën e djathtë, po ashtu edhe në të majtën.

Dijetarët janë në pajtim se mbajtja e unazës lejohet në të dy duart. Por ka mospajtim se te cila dorë të mbahet është më e pëlqyeshme? Imam Neveviu thotë se e djathta ka përparësi, sepse unaza është prej zbukurimit dhe begati prej Allahut subhanehu ue teala.

Hadithi 40

Xha’fer ibn Muhamedi, rahimehullah, prej atit të tij thotë: “*Haseni dhe Husejni, radijallahu anhuma, mbanin unazat në dorën e majtë.*” (Transmeton Tirmidhi)

Transmetuesi:

Xha’fer ibn Muhamed: ibn Ali ibn Husejn ibn Ali ibn Ebi Talib 148h.

Shpjegimi:

Ky transmetim tregon se çështja në këtë veprim është e gjerë, personi nëse dëshiron e mbanë unazën në dorën e djathtë, nëse dëshiron në të majtën, sepse në sunet të dy veprimet kanë bazë.

SHPATA

Hadithi 41

Enesi, radijallahu anhu, thotë: “*Fundi i kapëzës së shpatës së të Dërguarit të Allahut ﷺ ishte prej argjendi.*” (Transmeton Ebu Davudi, Nesai dhe Tirmidhi)

Transmetuesi:

Enesi: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

- “*Fundi i kapëzës së shpatës...*” Pjesa e fundit e kapëzës së shpatës që të mos rrëshqasë dora.
- “*...ishte prej argjendi.*” Ishte e punuar prej argjendit.

MBUROJA

Hadithi 42

Zubejr ibn Avvami, radijallahu anhu, tregon: “*Në ditën e Uhudit, i Dërguari i Allahut ﷺ kishte dy mburoja (parzmore). Kur tentoi të ngjitet në një shkëmb, nuk mundi. Kërkoi nga Talha që të ulet nën të, e ai u ngjit derisa qëndroi mbi shkëmb. Atëherë e dëgjova të Dërguarin ﷺ duke thënë: Talha meritoi Xhenetin!*” (Transmeton Tirmidhi)

Transmetuesi:

Zubejr ibn Avvami: Ibn Khuvejlid El-Kurashi 36h. Djali i hallës së të Dërguarit ﷺ. Një prej dhjetë sahabeve të përgëzuar me Xhenet.

Shpjegimi:

- “...kishte dy mburoja (parzmore).” i Dërguari ﷺ në betejën e Uhudit kishte veshur dy mburoja, njëren mbi tjetrën.
- “Kur tentoi të ngjitet në një shkëmb, nuk mundi.” Urtësia e ngjitjes së të Dërguarit ﷺ në shkëmb është që ta shohin krejt sahabet se ishte gjallë, sepse ishte përhapur lajmi se i Dërguari i Allahut ishte vvarë.

Në tentimin e parë nuk mundi të ngjitet në shkëmb. Shkaku mund të jetë madhësia e shkëmbit, ose veshja e dy mburojave të cilat peshonin rëndë, ose për shkak të plagëve që i kishte marrë në trupin e tij fisnik.

- “Kërkoi nga Talha që të ulet nën të, e ai u ngjit derisa qëndroi mbi shkëmb. Atëherë e dëgjova të Dërguarin ﷺ duke thënë: Talha meritoi Xhenetin!”

Talha ibn Ubejdullah në ditën e Uhudit, në mbrojtjen e fesë së Allahut dhe të Dërguarit të Tij sakrifikoi shumë. Duke e mbrojtur të Dërguarin ﷺ mori mbi njëzet plagë deri sa iu paralizua krahu me goditjen e një shigjete. E ndihmoi të Dërguarin ﷺ që të ngjitet në shkëmb dhe u përgëzua me Xhenet.

SARËKU

Hadithi 43

Amër ibn Hurejthi, radijallahu anhu, tregon: “E pash të Dërguarin e Allahut ﷺ duke mbajtur hutbe dhe mbi kokën e tij kishte sarëk të zi.” (Transmetojnë Muslimi, ibn Maxhe dhe Ebu Davud)

Transmetuesi:

Amër ibn Hurejthi el-Makhzumi 85h.

Shpjegimi:

Sarëk (Imame): Sarëku është një lloj veshje që lidhet në kokë dhe mbulon kokën. Sarëku është një veshje në traditën e arabëve të cilin e ka përdorur i Dërguari ﷺ dhe sahabet.

- “...duke mbajtur hutbe dhe mbi kokën e tij kishte sarëk të zi.” Dijetarët kanë thënë se i Dërguari ﷺ nuk e ka veshur sarëkun gjithmonë me ngjyrë të zezë.

Hadithi 44

Ibn Omeri, radijallahu anhumu, tregon: “Kur i Dërguari i Allahut e lidhte sarëkun, njërin skaj e lëshonte mes shpatullave.” (Transmeton Tirmidhi)

IZARI**Hadithi 45**

Ebu Burdete thotë: “Aishja na e nxori një mbulesë të trashë dhe një izar të vrazhdë dhe tha: *Iu mor shpirti të Dërguarit të Allahut ﷺ në këto dy veshje.*” (Transmetojnë Buhari, Muslimi, Ebu Davud dhe ibn Maxhe)

Transmetuesi:

Ebu Burdete ibn Ebu Musa el-Esh’ari. Emri i tij ishte Harith apo Amir, ose emri i tij ishte vetë *kunia* e tij. Imam dhe fekih i madh. Në datën e vdekjes së tij ka mospajtim, thuhet në vitin 103,104 ose 107 h.

Shpjegimi:

- *Izar:* Veshje me të cilën mbulohet pjesa e poshtme e trupit duke e mbështjellë trupin me të.

- *Rida:* Veshje me të cilën mbulohet pjesa e sipërme e trupit duke e hedhur mbi supe, pelerinë.

Hadithi 46

Hudhejfe ibn Jemani, radijallahu anhu, thotë: “*I Dërguari i Allahut ﷺ kapi pulpën time apo të veten (dëshon transmetuesi) dhe tha: Ky është vendi i izarit dhe nëse nuk dëshiron, atëherë nën të, dhe nëse nuk dëshiron, atëherë nuk i takon izarit të jetë në kyçe.*” (Transmeton Tirmidhi dhe ibn Maxhe)

Transmetuesi:

Hudhejfe ibn Jeman, Ebu Abdullah 36h. Sahabiu që i ka ditur sekretet.

Shpjegimi:

Ky hadith definon gjatësinë e veshjes së burrit musliman dhe tregon se deri ku mund të zgjatet veshja. Pra, lejohet prej nën gjurin e këmbës deri te kyçi i saj dhe nuk lejohet zgjatja e veshjes nën kyçin e këmbës për burrat musliman. Për këtë çështje kemi shumë hadithe. Transmeton Buhariu nga hadithi Ebu Hurejres radijAllahu anhu se i Dërguari ﷺ ka thënë: “*Ajo që është nën kyçin e këmbëve është në zjarr.*” (Buhariu – 5787)

SI ULEJ I DËRGUARI

Hadithi 47

Abdullah ibn Zejd, radijallahu anhu, tregon se ka parë të Dërguarin e Allahut ﷺ të shtrirë në xhami, kishte vendosur një rënë këmbë mbi tjetrën.” (Transmetojnë Buhari, Muslimi, Ebu Davud dhe Nesai)

Transmetuesi:

Abdullah ibn Zejd ibn Asim El-Ensari 63h. Sahabiu i cili e ka parë ezanin në ëndërr. Mori pjesë në vrasjen e Musejlemetul Kedh-dhabit.

Shpjegimi:

- “*...të shtrirë në xhami, kishte vendosur një rënë këmbë mbi tjetrën.*”

I shtrirë në tokë në shpinë duke vënë njërën këmbë mbi tjetrën. Zakonisht qëndrimi në këtë mënyrë nënkupton se trupi ka nevojë për pushim dhe qetësim dhe nuk praktikohet në vende publike, por në vende ku ka pak njerëz dhe në rrethin e ngushtë të shoqërisë.

Qëndrimi në këtë mënyrë (Mustelkijen) në një hadith¹ tjetër është ndaluar me kusht në rast se personi nuk ka rroba të brendshme dhe është i veshur vetëm me izar ose të ngjashme me të. Nëse këmba mbi të cilën vendoset këmba tjetër është e tërhequr dhe e lartësuar atëherë ndalohet qëndrimi në këtë mënyrë për shkak të mundësisë së zbulimit të auresit (vendeve të turpshme), përndryshe lejohet shtrirja në këtë mënyrë.

Hadithi 48

Ebu Se'id Khudriu, radijallahu anhu, tregon: “*I Dërguari i Allahut ﷺ kur ulej në xhami, me duar i bashkonte këmbët për gjoksi.*” (Transmetojnë Ebu Davudi dhe Bejhakiu)

Transmetuesi:

Ebu Se'id Khudriu: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

• “...*kur ulej në xhami, me duar i bashkonte këmbët për gjoksi.*” I Dërguari i Allahut ﷺ kur ulej në xhami, i tërhiqte këmbët dhe i ngjiste për barkun dhe këmbët i rrethonte me duart dhe i bashkonte të dy duart. Kjo mënyrë e të ulurit e qetëson trupin dhe nuk ka nevojë njeriu të mbështetet. Në gjuhën arabe ulja në këtë formë quhet الإحتباء “El-Ihtibaa”.

Hadithi 49

Xhabir ibn Semure, radijallahu anhu, thotë: “*Pashë të Dërguarin e Allahut ﷺ të mbështetur në jastëk nga ana e majtë.*” (Transmetojnë Ebu Davud dhe Tirmidhi)

Transmetuesi:

Xhabir ibn Semure: Është cekur më herët.

¹ Muslimi (5623)

Shpjegimi:

- “...të mbështetur në jastëk nga ana e majtë.” Njeriu ndonjëherë ka nevojë për tu mbështetur që të pushojë trupi. Kjo mbështetje herë bëhet nga ana e djathtë herë bëhet nga ana e majtë.

SI JETONTE I DËRGUARI**Hadithi 50**

Malik ibn Dinari, rahimehullah, thotë: “*I Dërguari i Allahut ﷺ, asnjëherë nuk u ngop me bukë dhe as mish, përveçse kur ulej me njerëz në gosti.*” (Transmeton Tirmidhi)

Transmetuesi:

Malik ibn Dinari: prej tabiinëve të mëdhenj 130h.

Shpjegimi:

- “...përveçse kur ulej me njerëz në gosti.” Domethënë; Të hajë bashkë me njerëz apo e ka kuptimin: Duart e shumta në ushqim.

Kur duart që marrin nga ushqimi janë shumë, atëherë ushqimi ka bereqet.

Ka thënë Imam Ahmedi (Allahu e mëshiroftë): Nëse në ushqim mblidhen katër gjëra atëherë plotësohet ushqimi;

- Fillimi i ushqimit të jetë me emrin e Allahut.
- Falënderimi i Allahut në fund.
- Duart e shumta në ushqim.
- Të jetë ushqim hallall.

Hadithi 51

Nu'man ibn Beshiri, radijallahu anhu, tha: “*A nuk hani dhe pini atë që dëshironi? E kam parë të Dërguarin tuaj ﷺ nuk gjente as hurmat më të këqija për ta mbushur barkun e tij.*” (Transmeton Muslim dhe Tirmidhi)

Transmetuesi:

Nu'man ibn Beshiri: El-Ensari (2 - 64h.)

Shpjegimi:

Nu'man ibn Beshiri radijAllahu anhu kur ka parë njerëz të cilët ankohen me gjithë atë rehati dhe furnizim të gjerë që e kanë poseduar me mirësinë e Allahut, atëherë, ua përkujtonte atyre gjendjen e të Dërguarit ﷺ që të marrin mësim.

Nga ky hadith kuptojmë se sa vlerë ka kjo botë tek Allahu i Madhëruar. Nëse do kishte vlerë kjo botë tek Furnizuesi, nuk do ta kishte lënë të Dashurin e tij ﷺ, të mjaftohet me furnizim të kufizuar.

Hadithi 52

Aishja, radijallahu anha, thotë: “*Ne, familja e të Dërguarit të Allahut ﷺ kalonim një muaj të tërë pa ndezur zjarr. Jetonim nga hurmat dhe uji.*” (Transmeton Buhari dhe Muslim).

Transmetuesja:

Aishja: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

- “*...kalonim një muaj të tërë pa ndezur zjarr. Jetonim nga hurmat dhe uji.*”

Nuk kanë gatuar asnjë ushqim për të cilin nevojitet zjarri. Si mishi, buka, gjellët e ndryshme etj. Ushqimi i vetëm me të cilin jetonin gjatë një muaji ishin hurmat dhe uji.

I Dërguari ﷺ nuk i ka kushtuar rëndësi ushqimit të mirë, por është mjaftuar me atë furnizim që e posedonte dhe nuk ankohej, por falënderonte Allahun. Brenga e tij ishte ngritja e fjalës së Allahut subhanehu ue teala e jo ushqimi i shumtë.

Hadithi 53

Enesi, radijallahu anhu, transmeton se i Dërguari ﷺ ka thënë: “Në rrugë të Allahut shijova frikën kur të tjerët nuk frikoheshin dhe pata mundime kur të tjerët nuk i kishin. Vinin dhe shkonin tridhjetë netë dhe ditë, kurse ushqimi i vetëm për mua dhe Bilalin që mund të hajë njeriu i gjallë ishte vetëm ajo që mund të mbante Bilali nën sjetull.” (Transmeton Tirmidhi)

Transmetuesi:

Enesi: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

I Dërguari i Allahut ﷺ ka përjetuar mundime të mëdha, tortura të ndryshme nga idhujtarët dhe armiqtë e fesë së Allahut gjatë thirrjes së tij në rrugë të Allahut. Prej mundimeve që ka përjetuar është edhe uria.

SI HANTE I DËRGUARI

Hadithi 54

Ka’b ibn Maliku, radijallahu anhu, thotë: “I Dërguari i Allahut ﷺ hante me tre gishtat e tij, e pastaj i lëpinte ato.” (Transmetojnë Muslim dhe Ebu Davud)

Transmetuesi:

Ka’b ibn Malik El-Ensari 50-51h. Poeti i të Dërguarit ﷺ. Njëri prej tri sahabëve të cilët pa leje prej të Dërguarit ﷺ munguan nga beteja dhe pastaj Allahu ua ka falur këtë gabim.

Shpjegimi:

Nga ky hadith kuptojmë dy rregulla për edukatën e ngrënies;

- *Ngrënia me tre gishta.* Këto tre gishta janë; gishti i madh, gishti tregues dhe gishti i mesëm, siç e kanë cekur dijetarët. Kjo vlen për ushqimet që mund të kapen me gishta. Nëse ka nevojë për ngrënie e ndonjë ushqimi të përdoren më shumë se tre gishta, atëherë përdoren.
- *Të lëpihen gishtat.* Kjo vepër bëhet pasi të përfundojë ngrënia, e jo gjatë ngrënies që të mos shqetësohen të tjerët që hanë. Urtësia e kësaj vepre është që të arrihet bereqeti i ushqimit. Mos të shkojë kot asnjë grimcë e ushqimit, sepse nuk dihet ku është bereqeti.

ÇFARË BUKE HANTE I DËRGUARI

Hadithi 55

Sulejm ibn Amir thotë: *E kam dëgjuar Ebu Umame El Bahiliun të thotë: “Buka e elbit asnjëherë nuk tepronte në shtëpinë e të Dërguarit ﷺ.”* (Transmetojnë Tirmidhi dhe Ahmedi)

Transmetuesi:

Ebu Umame El Bahili 86h.

Shpjegimi:

Hadithi tregon se sa pak ushqim ka pasur në shtëpinë e të Dërguarit ﷺ, sepse nuk tepronte gjë prej bukës së elbit, madje nuk ishte e mjaftueshme për ta mbushur barkun.

Aishja radijallahu anha, tregon: “Familja e tij nuk u ngop me bukë elbi, as dy ditë me radhë derisa i Dërguari i Allahut ﷺ u shpërngul në Ahiret.” (Transmeton Muslimi)

Prej këtyre transmetimeve kuptojmë se sa pak ka ngrënë i Dërguari ﷺ dhe sa pak vlerë ka kjo dynja tek Allahu. Nëse do kishte ndonjë vlerë kjo dynja tek Allahu i Madhëruar do ia kishte dhënë robit më të mirë të gjitha ushqimet më të mira dhe kënaqësitë e kësaj bote.

Hadithi 56

Ibn Abbasi, radijallahu anhu, tregon: *“I Dërguari i Allahut ﷺ dhe familja e tij net me radhë ngryseshin të uritur. Nuk kishin ç'të hanin për darkë. Buka që më së shpeshti e hanin ishte buka e elbit.”* (Transmeton Tirmidhi)

Transmetuesi:

Ibn Abbasi: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

- *“...Buka që më së shpeshti e hanin ishte buka e elbit.”* Kuptojmë se buka e cila gjendej më së shumti në sofrën e të Dërguarit ﷺ ka qenë buka e elbit.

Hadithi 57

Dikush pyeti Sehl ibn Sa'din, radijallahu anhu: *“A ka ngrënë i Dërguari i Allahut ﷺ bukë prej miellit të bardhë? - I Dërguari i Allahut ﷺ as që ka parë miell të bardhë derisa takoi Allahun. - u përgjigj Sehli. Iu tha: - A kishit sita në kohën e të Dërguarit ﷺ? Tha: Jo, nuk kishim. Iu tha: E çfarë bënit me elbin? Tha: Do ta frynim dhe pastrohej aq sa pastrohej, e pastaj do ta brumosnim.”* (Transmetojnë Buhari, Nesai, Tirmidhi dhe ibn Maxhe)

Transmetuesi:

Sehl ibn Sa'd El-Ensari 88h. Imam, prej sahabëve dijetarë.

USHQIMI DHE MËLMESAT

Hadithi 58

Aishja, radijallahu anhu, tregon se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: *“Sa mëlmesë e mirë që është uthulla.”* (Transmetojnë Muslim dhe Tirmidhi)

Transmetuesja:

Aishja: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

• *“Sa mëlmesë e mirë që është uthulla.”* Mëlmesë: gjellë a çdo ushqim tjetër që përdoret për të shoqëruar bukën. I Dërguari ﷺ e ka lavdëruar uthullën si mëlmesë, përshkak të mungesës së ndonjë mëlmesë më të mirë se ajo. Pra, jo se i ka pëlqyer më shumë se mëlmesat e tjera. Ai ﷺ gjithmonë ka qenë falënderues ndaj Allahut dhe nuk i ka përbuzur ushqimet.

Hadithi 60

Ebu Esidi, radijallahu anhu, transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: *“Hani vaj ulliri dhe lyhuni me të, sepse është prej drurit të bekuar.”* (Transmeton Tirmidhi)

Transmetuesi:

Ebu Esidi Malik ibn Rabiiah El-Ensari 40h.

Shpjegimi:

• *“Hani vaj ulliri...”* Përdoreni vajin e ullirit si mëlmesë, hani vajin e ullirit me bukë.

• *“... lyhuni me të ...”* Lyeni flokët dhe trupin (lëkurën) me të.

• *“...sepse është prej drurit të bekuar.”* Druri i ullirit është i bekuar përshkak të dobive që përmban, mjafton si argument për bekimin e këtij druri fjala e të Lartësuarit i cili betohet për të në Kuran: *“Pasha fikun dhe ullirin!”* (Surja Et-

Tin 1) dhe fjala e Allahut: "...ndizet prej (vajit të) një druri të bekuar, prej ullirit që nuk mund të quhet as i lindjes e as i perëndimit ..." (Surja En-Nur 35)

Hadithi 61

Enes ibn Maliku, radijallahu anhu, tregon: *"Një rrobaqepës e ftoi të Dërguarin e Allahut ﷺ për ushqim që e pat përgatitur. Enesi tha: Shkova me të Dërguarin ﷺ për atë ushqim. I ofroi të Dërguarit të Allahut ﷺ bukë elbi dhe gjellë kungulli me mish të thatë. Enesi tha: Pashë se si ai zgjedhte kungujt nga ena. Prej atë ditë edhe unë vazhdoj ti dua kungujt."* (Transmetojnë Buhari, Muslim, Tirmidhi dhe Ebu Davud).

Transmetuesi:

Enes ibn Malik: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

Përgjigja e të Dërguarit ﷺ ndaj kësaj ftese, tregon modestinë e tij ﷺ.

• *"I ofroi të Dërguarit të Allahut ﷺ bukë elbi dhe gjellë kungulli me mish të thatë.."* Nikoqiri ia ka ofruar ushqimin e përgatitur të Dërguarit ﷺ. Kjo është prej mikpritjes së mirë dhe nderimit të mysafirit.

Ushqimi ka qenë gjellë e lëngshme e përbërë prej kungujve dhe mishit të thatë.

• *"... pashë se si ai zgjedhte kungujt nga ena."* Ushqimi i përgatitur vendosej në një enë dhe të gjithë hanin prej saj. I Dërguari ﷺ i zgjedhte kungujt që i kishte përpara vetes dhe jo kungujt që ishin para dikujt tjetër, sepse kjo nuk lejohet. I Dërguari ﷺ na ka mësuar se në ushqim të përbashkët të hamë nga ajo që kemi para vetes. Transmetohet nga Umer ibn Ebi Seleme se I Dërguari ﷺ i ka thënë: *"O biri im! Thuaj Bismilah, ha me dorën e djathtë dhe ha para vetes."* (Buhariu dhe Muslimi)

• *"Prej atë ditë edhe unë vazhdoj ti dua kungujt."* Enesi radijallahu anhu i donte kungujt përshkak dashurisë që kishte për të Dërguarin ﷺ. Pra sahabët e ndiqnin të Dërguarin ﷺ në adhurime, moral madje edhe në çështjet e dynjallëkut.

Hadithi 62

Aishja, radijallahu anha, thotë: *"I Dërguari ﷺ i donte ëmbëlsirat dhe mjaltin."* (Transmetojnë Buhari, Muslim, Tirmidhi, Ebu Davud dhe ibn Maxhe)

Transmetuesja

Aishe: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

I Dërguari ﷺ i donte ushqimet dhe pijet e ëmbla, e sidomos mjaltin. Mu për këtë është potencuar në këtë hadith.

Hadithi 63

Abdullah ibn Harithi, radijallahu anhu, tregon: “*Hëngrëm me të Dërguarin ﷺ mish të pjekur në xhami.*” (Transmeton ibn Maxhe)

Transmetuesi:

Abdullah ibn Harith ibn Neufel ibn Harith ibn Abdulmuttalib.

Hadithi 64

Ebu Hurejre, radijallahu anhu, tregon: “*Të Dërguarit të Allahut ﷺ i sollën mish, dhe ia afruan kutin (e deles), sepse i pëlqente atij ﷺ dhe ai e kafshoi një copë nga ai.*” (Transmetojnë Buhari, Muslim, Tirmidhi dhe ibn Maxhe)

Transmetuesi:

Ebu Hurejre: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

- “... *sepse i pëlqente atij ﷺ.*” I Dërguari ﷺ e pëlqente këtë pjesë të mishit të deles për arsye se piqet më shpejt, është i dobishëm, me shije të mirë dhe se është pjesa e përparme të trupit e jo pjesa pasme.
- “... *kafshoi një copë nga mishi i kutit.*” Këtu përdoret folja “*كُفَسَ*” (nehese) që do të thotë: Kafshoi mishin me dhëmballët.

Hadithi 65

Enes ibn Maliku, radijallahu anhu, tregon se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Vlera e Aishes, radijallahu anha, mbi gratë tjera është sikur vlera e përsheshit me lëng mishi ndaj ushqimeve tjera.” (Transmetojnë Buhari, Muslim, Tirmidhi dhe ibn Maxhe)

Transmetuesi:

Enes ibn Malik: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

Në këtë hadith kuptojmë vlerën e madhe që ka nëna e besimtarëve, Aishja radijAllahu anha mbi gratë tjera.

Eth-theriidu: Përshesh i cili është me bukë të copëtuar i përzier me lëng mishi dhe ka mundësi të ketë edhe copa mishi. Asokohe konsiderohej ushqim i dalluar dhe i preferuar.

Hadithi 66

Enes ibn Maliku, radijallahu anhu, tregon: “Me rastin e martesës me Safijen, i Dërguari i Allahut ﷺ i gostiti dasmorët me hurma dhe mëmëligë me hurma.” (Transmeton Tirmidhi, Ebu Davud dhe ibn Maxhe)

Transmetuesi:

Enes ibn Malik: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

Safije bintu Hujejb ibn Ahtab (radijAllahu anha) nëna e besimtarëve, bashkëshortja e të Dërguarit të Allahut ﷺ.

Mëmëligë: Gatesë me miell misri, që përgatitet duke e zier dalëngadalë në ujë të valuar e duke e trazuar deri sa të trashet dhe pastaj përvëlohet zakonisht me gjalpë. Ndërsa në hadith është për qëllim përzierja e miellit me hurma.

Ndërsa në hadithin e transmetuar në Sahihun e Buhariut, tregohet se në dasmën e Safijes radijAllahu anha është përgatitur ushqim i përbërë prej hurmave, gjalpë dhe bashkë me të edhe miell.

Hadithi 67

Xhabiri, radijallahu anhu, tregon: “Doli i Dërguari i Allahut ﷺ dhe unë isha me të. Pastaj hyri tek një grua nga ensarët. Ajo theri një dele për të dhe ai hëngri prej saj. Pastaj solli një pjatë me hurma të freskëta. I Dërguari i Allahut ﷺ hëngri prej tyre. Mori abdes për namazin e drekës dhe e fali atë. Kur u kthye, ajo ia solli atë që kishte mbetur prej mishit të deles dhe ai hëngri. Pastaj fali ikindinë pa e ripërtërirë abdesin.” (Transmetojnë Tirmidhi, Ebu Davud, Nesai dhe ibn Maxhe)

Transmetuesi:

Xhabiri, radijallahu anhu: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

Nga ky hadith kuptojmë se i Dërguari ﷺ nuk ka marrë abdes për namazin e drekës përshkak se ka ngrënë nga mishi i deles, sepse pas ngrënies së të njëjtit mish për namazin e ikindisë nuk e ripërtëriu abdesin.

Përveç ngrënies së mishit të devesë asnjë lloj mishi nuk e prish abdesin.

Hadithi 68

Aishja, radijallahu anha, thotë: “Ndonjëherë kur i Dërguari i Allahut ﷺ hynte në shtëpi do të pyeste: A ka diçka për drekë? – Nuk ka - do të përgjigjesha. - Unë agjëroj - do të thoshte atëherë. Kur hyri një ditë, i thashë: Na është sjell dhuratë. - Çfarë dhurate? - më pyeti. - Hurma të shtypura me miell dhe gjalpë, u përgjigja. Sot jam gdhirë agjërueshëm. E pastaj hëngri, deklaroi ajo.” (Transmeton Tirmidhi)

Transmetuesja

Aishe, radijallahu anha: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

Ky hadith është argument se për agjërimin nafile (vullnetar) lejohet të bëhet nijeti deri në mesditë, me kusht që nëse nuk është vepruar pas imsakut diçka që e prish agjërimin. Ndërsa për agjërimin e obliguar medoemos nijeti duhet bërë natën, para imsakut (agimit) duke u argumentuar me hadithin të cilin e transmeton Aishe radijAllahu anha se i Dërguari ﷺ ka thënë: “*Kush nuk e bën nijetin e agjërimit natën para agimit, ai nuk ka agjërim.*” (Darakutnij Sunen-2213)

Dobia tjetër i këtij hadithi është se agjërimi nafile mund të priset dhe nuk duhet të kompensohet dhe nuk ka ndonjë qortim.

Hadithi 69

Enesi, radijallahu anhu, tregon: “*Të Dërguarit të Allahut ﷺ i pëlqente të hajë “Eth-thuflu”.* (Transmetojnë Ahmedi dhe Hakimi)

Transmetuesi:

Enes ibn Malik: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

- “... i pëlqente të hajë “Eth-thuflu” Të Dërguarit ﷺ i pëlqente të hajë pjesën e ushqimit të pjekur më shumë. Pra, pjesën e rreshkur.

Mësuesi i Tirmidhiut, Abullahu tha: Eth-thuflu d.m.th. atë që mbetet prej ushqimit.

ABDESI I TË DËRGUARIT PARA DHE PAS USHQIMIT

Hadithi 70

Ibn Abbasi, radijallahu anhu, thotë: “Kur i Dërguari i Allahut ﷺ doli nga nevojtorja, i ofruan ushqim dhe e i thanë: - A të të sjellim ujë për abdes? Ai tha: Jam urdhëruar që të marr abdes kur dëshiroj të falem.” (Transmetojnë Muslim, Ebu Davud dhe Nesai)

Transmetuesi:

Ibn Abbasi: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

Fjala الوضوء El-Vuduu (Abdesi) në gjuhën arabe ka dy përdorime:

- 1- Kuptimi gjuhësor: Larjen e duarve
- 2- Kuptimi shariatik: Abdesin

Në këtë hadith fjala El-Vuduu është përdorur në kuptimin shariatik, pra është për qëllim marrja e abdesit dhe i Dërguari ﷺ e ka sqaruar se për ngrënien e ushqimit nuk ka nevojë të merret abdes.

Ndërsa larja e duarve para dhe pas ushqimit është sunnet nëse ka nevojë për diç të tillë. Nëse duart janë të pastra, sipas mendimit më të saktë larja e duarve nuk është prej sunnetit.

ÇFARË THOSHTE I DËRGUARI PARA DHE PAS USHQIMIT

Hadithi 71

Aishja, radijallahu anha, transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “*Kur dikush han ushqim dhe harron të përmend Allahun e Madhëruar në ushqimin e tij, atëherë le të thotë: Bismil-lahi evvelehu ve akhirahu- Me emrin e Allahut - në fillim dhe në mbarim.*” (Transmetojnë Ebu Davud, Nesai dhe Tirmidhi)

Transmetuesja:

Aishe, radijallahu anha: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

Nëse dikush harron që para ushqimit të thotë Bismil-lah, kur ti kujtohet nëse thotë: Bismil-lahi evvelehu ve akhirahu- Me emrin e Allahut - në fillim dhe në mbarim, me lejen e Allahut dhe mëshirën e Tij arrihet bereqeti i ushqimit.

Hadithi 72

Omer ibn Ebi Seleme, radijallahu anhu, thotë se ka hyrë tek i Dërguari i Allahut ﷺ, ndërsa tek ai kishte ushqim. Tha: *Afrohu, biri im. Thuaj bismil-lah, ha me të djathtën dhe ha para vetes.*” (Transmetojnë Buhari, Muslim, Ebu Davud, Tirmidhi dhe ibn Maxhe)

Transmetuesi:

Omer ibn Ebi Seleme 83h: Djali i Ebu Selemes dhe Ummu Selemes radijAllahu anhum. Djali i bashkëshortes së të Dërguarit ﷺ e cila pasi ndërroi jetë burri i saj Ebu Seleme, u martua me të Dërguarin ﷺ. Omeri u edukua në shtëpinë e të Dërguarit ﷺ.

Shpjegimi:

- “...Biri im:” Fjalë përkëdhelëse që tregon mëshirë dhe mirësi. Njëkohësisht dëshmon për sjelljen e mirë e të Dërguarit ﷺ me të vegjlit. Kjo është argument se fëmijëve të huaj u lejohet tu thuhet “biri im”.

Në këtë hadith i Dërguari ﷺ na mëson tre shtylla prej edukatës së ngrënies.

- Përmendja e Allahut të Madhëruar në fillim të ushqimit.
- Ngrënia me dorën e djathtë.
- Ngrënia para vetes.

Hadithi 73

Enes ibn Maliku, radijallahu anhu, transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: *“Allahu është i kënaqur me robin e vet që hanë një kafshatë ushqim apo pi një gllënjë ujë dhe falënderon Allahun për të.”* (Transmetojnë Muslim, Nesai dhe Tirmidhi)

Transmetuesi:

Enes ibn Malik: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

Imam Tirmidhiu (rahimehullah) e ka përmendur këtë hadith në fund të kapitullit që të tregojë se pas kryerjes së ushqimit është sunnet të thuhet “elhamdulillah” dhe se falënderimi i Allahut është shkak për ta fituar kënaqësinë e Tij subhanehu ue teala.

GOTA**Hadithi 74**

Thabiti thotë: *“Enes ibn Maliku, radijallahu anhu, na nxori një gotë druri të vrazhdët, të përforcuar me hekur dhe tha: O Thabit, kjo është gota e të Dërguarit të Allahut, ﷺ.”* (Transmeton Buhari)

Transmetuesi:

Enes ibn Malik: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

Enesi radijAllahu anhu pas vdekjes së të Dërguarit ﷺ ka poseduar disa mjete të cilat i ka përdorur i Dërguari ﷺ për shkak se ai e ka shërbyer të Dërguarin ﷺ dhjetë vjet. Në këtë hadith Thabiti 127h. (Allahu e mëshiroftë) na e përshkruan gotën të cilën e ka përdorur i Dërguari ﷺ. Ajo ishte prej druri e përforcuar me hekur.

Transmetohet nga Enesi radijAllahu anhu të ketë thënë: *“I kam dhënë të pijë të Dërguarit ﷺ në këtë gotë të gjitha pijet: ujë, lëng, mjaltë dhe qumësht.”* (Sahihu Muslim 2008)

PEMËT**Hadithi 75**

Abdullah ibn Xha'feri, radijallahu anhu, thotë: *“I Dërguari i Allahut ﷺ hante trangull me hurma të freskëta.”* (Transmetojnë Buhari, Muslim, Tirmidhi, Ebu Davud dhe ibn Maxhe)

Transmetuesi:

Abdullah ibn Xha'fer ibn Ebi Talib 80h. Pasi që ra dëshmor babai i tij Xha'feri radijAllahu anhu në betejën e Mu'tes, Abdullahu mbeti jetim dhe për të u kujdes i Dërguari ﷺ.

Shpjegimi:

- *“...ka ngrënë trangull me hurma të freskëta.”* Hurmat e freskëta quhen Rutab dhe janë shumë të ëmbla dhe siç thonë arabët kanë nxehtësi. I Dërguari ﷺ për ta thyer ëmbëlsinë e hurmave të freskëta, bashkë më to ka hëngër trangull ose shalqi. Ky kombinim bëhet për ta stabilizuar ëmbëlsinë e hurmave të freskëta.

Edhe hadithi i ardhshëm komentohet njëjtë sikurse ky hadith.

Hadithi 76

Aishja, radijallahu anha, tregon: “*I Dërguari ﷺ ka ngrënë shalqi me hurma të freskëta.*” (Transmetojnë Ebu Davud, Tirmidhi dhe Nesai)

PIJET E TË DËRGUARIT ﷺ

Hadithi 77

Aishja, radijallahu anha, thotë: “*Pijet më të dashura të të Dërguarit të Allahut ﷺ ishin të ëmblat dhe të ftohtat.*” (Transmeton Tirmidhi)

Transmetuesja

Aishe, radijallahu anha: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

Hadithi na tregon se pijet të cilat i donte i Dërguari ﷺ përmbanin dy cilësi:

- Ëmbëlsinë
- Ftohtësinë

Në transmetime i gjejmë këto lloje të pijeve si p.sh.: sherbeti i mjaltit, lëngjet e përgatitura prej frutave (hurma, rrush të thatë etj.)

Dijetarët kanë thënë se edhe uji i pastër dhe që nuk është i njelmët hynë në këtë kategori.

Duhet të dihet se ftohtësia e përmendur në këtë hadith është ftohtësi mesatare e jo e tepruar sa që të dëmtoje shëndetin e njeriut.

SI PINTE I DËRGUARI

Hadithi 78

Abdullah ibn Amri, radijallahu anhu, thotë: “*Pashë të Dërguarin ﷺ që pinte duke qëndruar në këmbë dhe ulur.*” (Transmeton Tirmidhi)

Transmetuesi:

Abdullah ibn Amri ibnul As El Kurashij 63h.

Shpjegimi:

Në këtë hadith kuptojmë se i Dërguari i Allahut ﷺ ka pirë duke qëndruar në këmbë dhe duke qenë ulur edhe pse sunneti i tij i zakonshëm ishte pirja ulur.

Hadithi 79

Ibn Abbasi, radijallahu anhu, tregon: “*I dhashë të pijë të Dërguarit ﷺ nga uji zem-zem, e Ai piu duke qenë në këmbë.*” (Transmetojnë Buhari, Muslim, Tirmidhi, Nesai dhe ibn Maxhe)

Transmetuesi:

Ibn Abbasi: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

Në këtë hadith tregohet se i Dërguari i Allahut ﷺ ka pirë zemzem duke qenë në këmbë. Kjo vepër është e kundërta e zakonit të tij, por ky rast ishte rast nevoje.

Ka thënë Ibnul Kajjimi në Zadul Mead: Prej udhëzimit të tij ﷺ është të pirit duke qenë ulur dhe ky ishte udhëzimi i tij i zakonshëm. Kanë ardhur transmetime të sakta se i Dërguari i Allahut ﷺ ka ndaluar prej pirjes në këmbë dhe se e ka urdhëruar atë që ka pirë në këmbë të vjell, por kemi transmetime se i Dërguari ﷺ ka pirë në këmbë.

Një grup dijetarësh kanë thënë: Kjo ngjarje (ky hadith) është shfuqizim për ndalesën e të pirit në këmbë.

Një grup tjetër kanë thënë: Kjo ngjarje tregon se ndalesa e pirjes në këmbë nuk është haram (ndalesë e rreptë) por është mekruh (e urryer). Pra, në këtë çështje ndalesa ka ardhur që të zbatohet ajo që është më e pëlqyeshme.

Grupi tjetër kanë thënë: Në esencë nuk ka mospajtim mes dy transmetimeve, sepse i Dërguari i Allahut ﷺ ujin e zemzemit e ka pirë duke qëndruar në këmbë për shkak të situatës në të cilën gjendej dhe se nuk kishte hapësirë për të ulur.

Pra kur është mundësia për tu ulur gjatë pirjes ulemi dhe e praktikojmë sunetin e të Dërguarit ﷺ dhe kur s’kemi mundësi të ulemi pimë duke qëndruar në këmbë dhe s’kemi vepruar diçka të urryer e as mëkat.

Hadithi 80

Enes ibn Maliku, radijallahu anhu, tregon: *“I Dërguari ﷺ kur pinte ujë merrte frymë tre herë, dhe thoshte: - Kjo është më e këndshme dhe më mirë shuan etjen.”* (Transmetojnë Muslim, Ebu Davud, Tirmidhi dhe Nesai)

Transmetuesi:

Enes ibn Malik: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

- *“...kur pinte ujë merrte frymë tre herë...”* E pinte ujin ndërprerje, pas çdo pirjeje merrte frymë.
- *“...Kjo është më e këndshme...”* Më lehtë përcillet uji në lukth.

PARFUMI I TË DËRGUIARIT ﷺ

Hadithi 81

Enes ibn Maliku, radijallahu anhu, thotë: *“I Dërguari i Allahut ﷺ kishte një enë të veçantë për parfum prej së cilës parfumohej.”* (Transmeton Ebu Davud)

Transmetuesi:

Enes ibn Malik: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

• “...kishte një enë të veçantë për parfum prej së cilës parfumohej.” Ena në të cilën gjendet apo ruhet parfumi quhet “Sukkeh”. E në këtë transmetim kuptojmë se i Dërguari ﷺ kishte sukkeh prej së cilës parfumohej vazhdimisht.

Hadithi 82

Ibn Omeri, radijallahu anhu, thotë: I Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “*Tre gjëra nuk refuzohen: jastëkët, parfumi dhe qumështi.*” (Transmeton Tirmidhi)

SI FLISTE I DËRGUARI ﷺ**Hadithi 83**

Aishja, radijallahu anha, thotë: “*I Dërguari ﷺ nuk fliste shpejt sikur veproni ju, por ai fliste qartë, ndante fjalët, saqë e mbante mend secili që ulej me të.*” (Transmetojnë Buhari, Muslim, Ebu Davud dhe Tirmidhi)

Transmetuesja

Aishe, radijallahu anha: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

• “*i Dërguari ﷺ nuk i recitonte fjalët shpejt sikur veproni ju.*” Nuk shpejtonte në të folurit e tij por edhe mes fjalëve nuk kishte heshtje të gjatë sa të formohet zbrastirë e cila e prish orientimin e të folurit.

• “*Të folurit e tij ishte i qartë, ndante fjalinë, ...*” i Dërguari ﷺ ishte njeriu më i qartë në të folurit përshkak misionit të tij që kishte. Ai kur fliste, kuptimi apo qëllimi i fjalës së tij arrinte tek dëgjuesi në mënyrë shumë të lehtë dhe të shpejtë. Fjalët e tij ishin të bukura, matura dhe tërhiqnin zemrat e njerëzve, sepse janë të vërteta dhe udhëzime.

Ndante fjalinë në mënyrë të qartë sa që dëgjuesi kishtë mundësi ti numërojë fjalt e tij.

- “... *saqë e mbante mend secili që ulej pranë tij.*” Me që i Dërguari ﷺ në të folurit e tij ishte i matur në shpejtësi, i qartë në kuptime dhe ndante fjalinë në mënyrë të kuptueshme, secili dëgjuës mbante mend udhëzimet e tij të cilat i shpallehin nga Zoti i gjithësisë.

Hadithi 84

Enes ibn Maliku, radijallahu anhu, thotë: “*I Dërguari i Allahut ﷺ përsëriste fjalën tri herë që të jetë më i kuptueshëm.*” (Transmetojnë Buhari dhe Tirmidhi).

Transmetuesi:

Enes ibn Malik: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

- “...*përsëriste fjalën tri herë që të jetë më i kuptueshëm.*” Kjo vlen për fjalët e tij ﷺ që janë në lidhje me dispozitat (hallall ose haram) e fesë së Allahut subhanehu ue Teala, e jo në bisedat e përditshme.

TË QESHURIT E TË DËRGUARIT ﷺ

Hadithi 85

Abdullah ibn Harithi, radijallahu anhu, tregon: “*Askënd nuk kam parë më të buzëqeshur sesa të Dërguarin e Allahut ﷺ.*”

Në një transmetim tjetër thuhet: “*Nuk ishte të qeshurit e të Dërguarit ﷺ vetëm se buzëqeshje.*” (Transmetojnë Tirmidhi dhe Ahmed)

Transmetuesi:

Abdullah ibn Harith ibn Neufel ibn Harith ibn Abdulmuttalib.

Shpjegimi:

- “Askënd nuk kam parë më të buzëqeshur sesa të Dërguarin e Allahut ﷺ.” Hadithi tregon se sa shumë buzëqeshte i Dërguari ﷺ dhe ishte i përkryer në moralin dhe sjelljen e tij me të tjerët, dëshmon modestinë dhe optimizmin në jetën e tij ﷺ. Ai njashtu udhëzonte pasuesit e tij për të qenë optimist në sfidat e jetës.
- “Nuk ishte të qeshurit e të Dërguarit ﷺ vetëm se buzëqeshje.” Si në të gjitha çështjet, i Dërguari i Allahut ﷺ edhe në të qeshurit ka qenë mesatar. Nuk qeshej me zë të lartë por buzëqeshte.

Ndonjëherë kur buzëqeshte më shumë i dukeshin vetëm dhëmballët dhe zërin kishte mundësi t’ia dëgjonte vetëm ai që ishte pranë tij.

I Dërguari i Allahut ﷺ na inkurajon për buzëqeshje dhe thotë: “Buzëqeshja jote në fytyrën e vëllait tënd është sadaka (lëmoshë)” (Tirmidhiu 1956 – Ibnu Hibban 529)

Buzëqeshja fut gëzim në zemrën e besimtarëve dhe i afron ata mes veti, si dhe jep mundësinë e thirrjes në fenë e Allahut subhanehu ue teala dhe këshillimit të dobishëm.

Hadithi 86

Xherir ibn Abdullahu, radijallahu anhu, tregon: “Që kur pranova Islamin i Dërguari ﷺ asnjëherë nuk më ndaloi dhe nuk më shihte e mos të buzëqeshej.” (Transmetojnë Buhari, Muslim, Ebu Davud, Tirmidhi dhe ibn Maxhe)

Transmetuesi:

Xherir ibn Abdullah El Bexhelij 51h. ose 54h.

Shpjegimi:

- “...nuk më shihte e mos të buzëqeshej.” Kjo tregon se buzëqeshja nuk duhet të mungojë në fytyrën e besimtarit, pa marrë parasysh vështirësitë e kësaj jete.

Hadithi 87

Abdullah ibn Mes’udi, radijallahu anhu, transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Unë e di atë të cilin i fundit do të dalë prej Xhehennemit. Një burrë

i cili do të del nga ai zvarrë dhe do t'i thuhet: - Nisu dhe hyr në Xhennet! Tha: Ai do të niset për të hyrë në Xhennet dhe i gjen njerëzit më i kanë zënë vendet, kthehet dhe thotë: O Zot, njerëzit më i kanë zënë vendet! – Atij do i thuhet: A të kujtohet koha në të cilën ishe? Do të thotë: - Po. Pastaj do t'i thuhet: - Dëshiro! – Dhe ai do të dëshirojë. Pastaj do t'i thuhet: - Të jepet ajo që dëshirove dhe dhjetë herë sa dynjaja. Thotë: A po tallesh me mua, e Ti je Sunduesi! Thotë: Atëherë pashë të Dërguarin ﷺ se qeshi derisa iu panë dhëmballët.” (Transmetojnë Buhari, Muslim, Tirmidhi dhe ibn Maxhe)

Transmetuesi:

Abdullah ibn Mes'ud El Hedhelij El Mekkiy 32h. Fekihu (juristi) i ummetit, prej muslimanëve të parë. Abdullah ibn Mes'udi thotë: “Më ke parë një nga gjashtë personat dhe nuk ka pasur në sipërfaqen e tokës musliman përpos neve.

Shpjegimi:

I Dërguari ﷺ pas tregimit të një ngjarjeje të këndshme që do të ndodhë në Ditën e Gjykimit ka qeshur derisa i janë parë dhëmballët. Kjo ndodhte kur i Dërguari ﷺ qeshte më shumë.

SI MAHITEJ I DËRGUARI

Hadithi 88

Enes ibn Maliku, radijallahu anhu, transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ i tha: “*O ti me dy veshë!*” (Transmetojnë Tirmidhi dhe Ebu Davud)

Transmetuesi

Enes ibn Malik: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

Qëllimi i mahitjes është futja e gëzimit në zemrat e njerëzve, shtimi i dashurisë dhe marrëdhënieve të mira mes tyre.

Për këtë arsye edhe i Dërguari ﷺ ka bërë shaka me familjarët dhe sahabet (radijAllahu anhum), me maturi, sipas nevojës dhe në vend të duhur. Kur ka bërë shaka nuk e ka folur vetëmse të vërtetën.

Shakaja e muslimanit duhet të jetë larg talljes dhe larg fjalëve dhe veprave ofenduese për të tjerët. Padyshim muslimani nuk duhet të teproje në çështjen e shakasë sepse ajo shkakton të qeshurit e tepërt që e vdes zemrën, e pastaj nuk ndikohet nga udhëzimet e fesë së Allahut. Shakaja e tepruar njëkohësisht shkakton armiqësi mes njerëzve dhe prish seriozitetin e personit.

- “*O ti me dy veshë!*” Meqë Enesi radijAllahu anhu e ka shërbyer të Dërguarin ﷺ dhjetë vite, i Dërguari ﷺ mahitej me të duke bërë shaka të matura, që sjellin gëzim dhe jo ofenduese.

Hadithi 89

Enes ibn Maliku, radijallahu anhu, thotë: “*I Dërguari i Allahut ﷺ mahitej me ne (fëmijët), madje një herë i tha vëllait tim të vogël: O Ebu Umejr, ç’bëri nugajri?*” (Transmetojnë Buhari, Muslim, Ebu Davud, Nesai, Tirmidhi dhe ibn Maxhe)

Transmetuesi

Enes ibn Malik: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

- “*O Ebu Umejr, ç’bëri nugajri?*” I Dërguari ﷺ shkoi të ngushëllojë vëllain e Enesit, Ebu Umejrin, radijaAllahu anhu për shkak se i kishte ngordhur zogu për të cilin kujdesej. Kështu ia largoj pikëllimin me një shaka që ishte me vend. Ky ishte i Dërguari i Allahut ﷺ i cili i gëzonte të mëdhenjtë e të vegjlit me moralin dhe sjelljen e tij të përsosur.

Hadithi 90

Ebu Hurejre, radijallahu anhu, tregon se i kanë thënë të Dërguarit të Allahut, ﷺ: “*O i Dërguari i Allahut ﷺ ti po mahitesh me ne? Tha: Po, por unë flas vetëm të vërtetën.*” (Transmeton Tirmidhi)

Transmetuesi:

Ebu Hurejre: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

• “O i Dërguari i Allahut ﷺ ti po mahitesh me ne? Tha: *Po, por unë flas vetëm të vërtetën.*” Udhëzimi i të Dërguarit ﷺ është bërja e shakasë me fjalë të vërteta e jo me gënjeshtër.

I Dërguari ﷺ në hadith të saktë thotë: “*Unë i premtoj një shtëpi në mes të xhennetit atij që e braktis gënjeshtërën edhe qoftë në mahi.*” (Ebu Davud)

SI FLINTE I DËRGUARI ﷺ

Hadithi 91

Berra ibn Azibi, radijallahu anhu, thotë: “*Kur i Dërguari i Allahut ﷺ shtrihej në shtrat, dorën e djathtë e vinte nën faqen e djathtë dhe thoshte: O Zot, më ruaj nga dënimi Ditën kur do t’i ngjallësh robërit Tu.*” (Transmeton Tirmidhi)

Transmetuesi:

Berra ibn Azibi: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

Në këtë hadith gjejmë tre rregulla nga edukata e gjumit të cilat janë sunnet të praktikohen për besimtarin kur të shtrihet për të fjetur.

- 1- Shtrirja në krahun e djathtë.
- 2- Vendosja e dorës së djathtë nën faqen e djathtë.
- 3- Leximi i lutjes; “*O Zot, më ruaj nga dënimi Ditën kur do t’i ngjallësh robërit Tu.*”

Lutja e të Dërguarit ﷺ në këtë gjendje dhe moment është e përshtatshme sepse gjumi rikujton vdekjen, madje Allahu i madhëruar në gjumë i merr shpirtrat, për këtë dëshmon fjala e Allahut: “*Allahu i merr shpirtrat kur është momenti i vdekjes së tyre (i vdekjes së trupave të tyre), e edhe atë që është në gjumë e nuk ka vdekur, e atij që i është caktuar vdekja e mban (nuk e kthen), e atë tjetrin (që nuk i është caktuar vdekja, por është në gjumë), e lëshon (të kthehet) deri në afatin e caktuar. Vërtet, në këto ka argumente për një popull që mendon.*” (Zumer-42)

Dhe në hadithin e ardhshëm do të shohim se i Dërguari i Allahut ﷺ kur zgjohej nga gjumi bënte lutjen; “*Falënderimi i takon Allahut, i Cili na ngjalli pasi që*

na mori jetën dhe para tij do të ringjallemi.” që tregon se pas vdekjes ka ringjallje, llogari dhe shpërblim ose dënim. Pra gjumi rikujton të gjitha këto dhe kjo lutje përshtatet me këtë rast.

Hadithi 92

Hudhejfe, radijallahu anhu, tregon: *“I Dërguari i Allahut ﷺ kur shtrihej në shtrat do të lexonte: O Allah, me emrin Tënd vdes dhe ngjallem. Kurse kur zgjohej lexonte: Falënderimi i takon Allahut, i Cili na ngjalli pasi që na mori jetën dhe tek Ai do të ringjallemi.”* (Transmetojnë Tirmidhi, Buhari, Ebu Davud dhe ibn Maxhe)

Transmetuesi:

Hudhejfe: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

Në këtë hadith kuptojmë se robi ka nevojë që ta përmende Allahun i cili ia merr shpirtin, e ngjallë dhe ia rregullon të gjitha çështjet. Pra, robi e përmend Zotin e tij në çdo rast, flenë dhe zgjohet duke e përmendur dhe falënderuar Allahun subhanehu ue teala. Robi krejt qenien e tij ia kushton Zotit të gjithësisë. Allahu thotë: *“Thuaj: “Namazi im, kurhani im, jeta dhe vdekja ime janë thjesht për Allahun, Zotin e botëve”. (En’am-162)*

Hadithi 93

Aishja, radijallahu anha, tregon: *“Çdo natë, kur shtrihej në shtrat, i Dërguari ﷺ do t’i bashkonte shuplakat dhe pastaj frynte në to dhe lexonte Kul huvAllahu ehad-in, Kul eudhu bi rrabbil-felek-un dhe Kul eudhu bi rrabbil-nas-in, pastaj me duar do të fërkonte aq sa kishte mundësi nga trupi i tij, fillonte me kokën, fytyrën dhe pjesën e përparme të trupit. Kështu vepronte tri herë.”* (Transmetojnë Buhari, Muslim, Tirmidhi, ibn Maxhe dhe Ebu Davud)

Transmetuesja

Aishe, radijallahu anha: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

- “Çdo natë, kur shtrihej ...” I Dërguari ﷺ vazhdimisht e praktikonte këtë vepër kur shtrihej për të fjetur.
- “...do t’i bashkonte shuplakat,” Shuplakat i mbante si në formën kur bëhet dua (lutje) dhe i ngjiste duart, pra i bashkonte dy duart.
- “...dhe pastaj frynte në to dhe lexonte *Kul huvAllahu ehad-in, Kul eudhu bi rrabbil-felek-un dhe Kul eudhu bi rrabb-in-nas-in, pastaj me duar do të fërkonte aq sa kishte mundësi nga trupi i tij.*” Në shuplaka lexonte tre suret e fundit të Kuranit, el-ihlas, el-felek, en-nas dhe do të frynte me pështym në duar dhe pastaj do të fërkonte tërë trupin.

Ky sunnet i të Dërguarit ﷺ me lejen e Allahut është paqe dhe bereqet për trupin dhe shpirtin e njeriut. Praktikuesi i këtij sunneti me lejen e Allahut e mbron veten tij nga shejtani i mallkuar, magjia, mësysh dhe njëkohësisht e mbron trupin e tij nga gjallesat e dëmshme siç janë insektet etj.

Këshillë: Kur e praktikojmë këtë sunnet mos harrojmë që ti fërkujmë ose ti fryjmë edhe fëmijët tanë të vegjël derisa ata të mësohen vet ta praktikojnë këtë sunnet.

IBADETI

Hadithi 94

Mugire ibn Shu’be, radijallahu anhu, tregon: “I Dërguari i Allahut ﷺ falej derisa i ënjteshin këmbët. Iu tha: O i Dërguari i Allahut, përse mbingarkohesh ndërsa Allahu t’i ka falur të gjitha mëkatet e së kaluarës dhe të ardhmes? Tha: E si të mos jem rob falënderues!” (Transmetojnë Buhari, Muslim, Nesai dhe ibn Maxhe)

Transmetuesja:

Mugire ibn Shu’be 50h.

Shpjegimi:

- “...falej derisa i ënjteshin këmbët.” I Dërguari ﷺ falej namaz nate aq gjatë sa që i ënjteshin këmbët prej qëndrimit të gjatë në këmbë.

• “*E si të mos jem rob falënderues!*” Kur e pyeste ndokush të Dërguarin ﷺ se përse ngarkohet aq shumë deri sa ti ënjten këmbët kur Allahu ia ka falur të gjitha mëkatet, Ai përgjigjej “*E si të mos jem rob falënderues!*”, që do të thotë: Si të mos e falënderoj Allahun për këtë gjë, kurse Ai me mirësinë dhe mëshirën e Tij më begatoi me faljen e gjynaheve.

Shukri (falënderimi) bëhet me zemër duke qenë mirënjohës ndaj Allahut për begatinë e dhënë, me gjuhë duke e përmendur Allahun, Dhuruesin e mirësisë dhe me gjymtyrë duke e adhuruar Allahun, siç e ka adhuruar i Dërguari i Tij ﷺ me namaz etj.

Hadithi 95

Esved ibn Jezidi tregon se ka pyetur Aishen, radijallahu anha, për namazin e natës të Dërguari të Allahut ﷺ? Tha: “*Pjesën e parë të natës e kalonte në gjumë, e pastaj çohet. E kur arrinte pjesa e fundit e natës falte vitrin, e pastaj u kthente në shtratin e tij. E nëse kishte dëshirë, i afrohej gruas së vet (për marrëdhënie intime). Kur e dëgjonte ezani ngrihej me hov, e nëse ishte xhunub lahej, e nëse jo, atëherë merrte abdes dhe shkonte në namaz.*” (Transmetojnë Tirmidhi, Muslim, Nesai dhe Buhari)

Transmetuesi:

Esved ibn Jezidi ibn Kajs 75h. Esvedi është *mukhadram* që do të thotë e ka arritur të Dërguarin ﷺ por nuk e ka takuar Atë.

Shpjegimi:

- Esved ibn Jezidi tregon se ka pyetur Aishen, radijallahu anha, për namazin e natës të Dërguari të Allahut ﷺ. Nga kjo pyetje kuptojmë interesimin e selefit (të parëve) për çështjet e fesë së Allahut subhanehu ue teala.
- “*...Pjesën e parë të natës e kalonte në gjumë.*” Gjysmën e parë të natës e kalonte në gjumë.
- “*E kur arrinte pjesa e fundit e natës falte vitrin, ...*” Pasiqë e kalonte gjysmën e parë të natës në gjumë, zgjohej në mesnatë dhe falte namaz nate duke e lënë vitrin për në fund.
- “*...E nëse kishte dëshirë, i afrohej gruas së vet (për marrëdhënie intime)*” Në pjesën e fundit të natës nëse dëshironte i afrohej gruas. Në këtë kohë para namazit të sabahut i Dërguari ﷺ flinte që të pushojë për të qenë i kthjelltë për namaz të sabahut.

- “Kur e dëgjonte ezani ngrihej me hov...” Këtu për fjalën “ngrihej” përdoret folja “وُثِبَ” (wethebe) që do të thotë: ngrihej me plot dëshirë dhe vullnet për ta falur namazin e sabahut i cili është namaz i detyrueshëm.

Hadithi 96

Ibn Abbasi, radijallahu anhu, thotë: “I Dërguari ﷺ natën falte trembëdhjetë rekatë.” (Transmetojnë Buhari, Muslim dhe Tirmidhi)

Transmetuesi:

ibn Abbasi: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

I Dërguari ﷺ natën falte gjashtë herë nga dy rekatë, pastaj falte një rekatë (vitr) në fund.

Kemi transmetime se natën ka falur nëntë rekatë dhe njëmbëdhjetë rekatë.

Dijetarët kanë thënë se kjo ka ndodhur në kohë të ndryshme. Pra, ndonjëherë ka falur trembëdhjetë rekatë, ndonjëherë më pak. Të gjitha transmetimet janë të sakta dhe veprohet me to.

Hadithi 97

Aishja, radijallahu anha, tregon: “I Dërguari i Allahut ﷺ tërë natën u fal vetëm me një ajet.” (Transmeton Tirmidhi në Shemail)

Transmetuesja:

Aishe, radijallahu anha: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

- “I Dërguari i Allahut ﷺ tërë natën u fal vetëm me një ajet.” Kjo është argument se në namaz mundet të përsëritet i njëjti ajet opo sure, qoftë në të njëjtin rekatë ose në tërë namazin e natës.

Transmeton Imam Ahmedi (rahimehullah) në Musnedin e tij nga Ebu Dherri (radijAllahu anhu) se i Dërguari ﷺ në namazin e natës ka lexuar një ajet derisa ka ardhur koha e namazit të sabahut, ka bërë sexhde dhe ruku me këtë ajet:

“Nëse i dënon ata, në të vërtetë ata janë robërit Tu, e nëse i falë ata, Ti je i gjithëfuqishmi, i urti.” (Maide-118)

Ibn Kajjimi (rahimehullah) në librin e tij “Miftahu Dari es-Seadeh” thotë: “Nëse do ta dinin njerëzit se çfarë vlere ka në leximin e Kuranit me meditim, do angazhoheshin me të e jo me gjëra tjera. Kur e lexon atë me vëmendje derisa lexon ndonjë ajet për të cilin ka nevojë dhe është shërim për zemrën e tij, e përsërit këtë ajet njëqind herë por edhe tërë natën. Leximi i një ajeti me meditim dhe kuptim të thellë është më me vlerë se sa leximi i tërë Kuranit pa meditim dhe kuptim dhe më i dobishëm për zemrën dhe realizimin e imanit të plotë dhe shijimit të ëmbëlsisë së tij. Kjo ka qenë tradita e të parëve (selefit), të cilët lexonin të njëjtin ajet deri në mëngjes”.

Hadithi 98

Aishja, radijallahu anha, thotë: *“I Dërguari ﷺ falej ulur dhe recitonte duke qenë ulur. E kur i mbetnin edhe tridhjetë apo dyzet ajete, do të çohesh për t'i recituar në këmbë. Pastaj bënte ruku dhe sexhde dhe ashtu vepronte edhe në rekatin tjetër.”* (Transmetojnë Buhari, Muslim, Ebu Davud, Tirmidhi, Nesai dhe ibn Maxhe)

Transmetuesja:

Aishe, radijallahu anha: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

I Dërguari ﷺ ndonjëherë në namazin e natës falej ulur nga lodhja, sëmundja, mosha apo për ndonjë arsye të ngjashme. Lexonte duke qenë ulur derisa mbetnin tridhjetë apo dyzet ajete, pastaj çohesh për ti lexuar këto tridhjetë ose dyzet ajete në këmbë dhe pastaj bënte ruku dhe sexhde.

SI E FALTE NAMAZIN DUHA I DËRGUARI ﷺ

Hadithi 99

Muadheja, rahimehAllah, tregon: “*I thashë Aishes, radijallahu anha: A ka falur i Dërguari i Allahut ﷺ namazin e Duhasë? Tha: Po, katër rekatë dhe shtonte aq sa donte Allahu.*” (Transmetojnë Muslim dhe ibn Maxhe)

Transmetuesja:

Aishe, radijallahu anha: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

Namazi i Duhasë është namaz nafile që mund të falet më së paku dy rekatë, e deri sa të dëshirojë muslimani duke dhënë selam në çdo dy rekatë. Koha kur mund të falet namazi i Duhasë është pesëmbëdhjetë minuta pas lindjes së diellit, e deri kur dielli arrin në kupën e qiellit (zenit).

Nga hadithet që flasin për këtë tematik është edhe hadithi i Ebu Dherrit i cili përcjell se i Dërguari ﷺ ka thënë: “*Çdo ditë në të cilën lind dielli, secili prej jush duhet të jep sadaka për çdo nyje (kockash) të trupit të tij. Në çdo tesbih (subhanallah) ka sadaka, në çdo tehmîd (elhamdulillah) ka sadaka, në çdo tehlîl (la ilahe il Allah) ka sadaka, në çdo tekbir (Allahu ekber) ka sadaka, këshillimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja është sadaka dhe mjaftojnë si shlyerje për të gjitha këto, dy rekatë që falen paradite.*” (Muslimi)

Hadithi 100

Abdurrahman ibn Ebi Lejla thotë: “*Nuk më ka treguar askush se i Dërguari ﷺ e falte namazin e duhasë, përpos Ummu Hani, radijallahu anha, e cila më ka treguar se i Dërguari i Allahut ﷺ hyri në shtëpinë e saj ditën kur u çlirua Mekka, u la dhe i fali tetë rekatë. Asnjëherë nuk e kam parë të falë namaz më të shkurtë, përpos se ai plotësonte rukun dhe sexhden.*” (Transmetojnë Buhari, Muslim, Ebu Davud, Nesai dhe ibn Maxhe)

Transmetuesja

Ummi Hani: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

- “...i fali tetë rekatë.” Në këtë rast i Dërguari ﷺ ka falur tetë rekatë namaz duha dhe kjo nuk është në kundërshtim me hadithin e Aishes radijAllahu anha e cila thotë: “...katër rekatë dhe shtonte aq sa donte Allahu.” Pra ndonjëherë falte dhe më tepër se katër rekatë siç është transmetuar në këtë hadith.
- “Asnjëherë nuk e kam parë të falë namaz më të shkurtë, përpos se ai plotësonte rukun dhe sexhden.” I Dërguari ﷺ nuk e zgjaste namazin e duhasë siç e zgjaste namazin e natës, në namazin e duhasë lexonte shkurtë por rukun dhe sexhden i bënte me qetësi dhe i plotësonte ato.

TË FALURIT E NAFILEVE NË SHTËPI

Hadithi 101

Abdullah ibn Sa'di, radijallahu anhu, thotë: “Pyeta të Dërguarin, ﷺ: për namazin në shtëpinë time apo në xhami? *Tha: A e sheh sa afër xhamisë është shtëpia ime, por më e dashur për mua është që të falem në shtëpi se sa në xhami, përveç farzit.*” (Transmeton Ebu Davud dhe ibn Maxhe)

Transmetuesi:

Abdullah ibn Sa'd El-Kurashij. Ka ndërruar jetë në kohën (hilafetin) e Aliut radijAllahu anhumu.

Shpjegimi:

Namazi nafile është ai namaz i cili nuk është obligim. Si sunnetet e pesë kohëve të namazit, namazi i natës, namazi i duhasë etj.

Namazi nafile më mirë është të falet në shtëpi se sa të falet në xhami, edhe nëse xhamija në të cilën falet muslimani është njëra prej tre xhamive të shenjta, (Qabeja, Xhamia e të Dërguarit ﷺ dhe Xhamia el-Aksa) në të cilat shumëfishohet vlera e namazit.

Të falurit e nafileve në shtëpi e gjallëron shtëpinë, sepse një shtëpi në të cilën nuk adhurohet Allahu, ajo shtëpi është e vdekur. I Dërguari ﷺ thotë: “*Mos i bëni shtëpitë tuaja varreza*”. (Ebu Davud)

Andaj muslimani duhet ti falë namazet nafile në shtëpi, kurse namazet farz (obligative) duhet ti falë në xhami. Kjo vlen për burrat musliman, ndërsa për gratë muslimane më mirë është që ti falin të gjitha namazet në shtëpitë e tyre. I Dërguari ﷺ thotë: “Mos i ndaloni gratë tuaja nga xhamitë, por shtëpitë e tyre janë më mirë për to”. (Ebu Davud, Hakim)

Prej dobive të falurit të nafileve në shtëpi:

- Nxitja e fëmijëve në faljen e namazit.
- Largimi i shejtanëve nga shtëpia.
- Të falurit e namazit në shtëpi sjell qetësi, mirësi dhe bereqet me lejen e Allahut.

AGJËRIMI I TË DËRGUARIT ﷺ

Hadithi 102

Abdullah ibn Shekiku thotë: *E kam pyetur Aishen, radijallahu anha, për agjërimin e të Dërguarit ﷺ me ç'rast tha: “Agjëronte sa që thoshim se do të agjërojë (përherë) dhe ndonjëherë ndërpriste agjërimin, saqë thoshim se nuk do të agjërojë (kurrë). Qëkur erdhi në Medine, i Dërguari ﷺ asnjëherë nuk ka agjëruar tërë muajin, përveçse muajin ramazan.”* (Transmetojnë Tirmidhi, Ebu Davud, Muslim dhe Nesai)

Transmetuesja:

Aishe radijAllau anha: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

Agjërimi në kuptimin gjuhësor: Abstenim, pengim dhe kufizim i nefsit.

Në kuptimin sheriatik: Të abstenosh prej hajes, pijes dhe prej gjërave tjera që e prishin agjërimin, me nijet, nga agimi i mëngjesit deri në perëndimin e Diellit.

Allahu thotë:

“O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm.” (ElBekare: 183)

Agjërimi është një adhurim madhështor që mbjell devotshmërinë ndaj Allahut të Madhëruar në zemra, ngjall lidhjen e fortë me Allahun dhe i bën njerëzit që të largohen nga të ndaluarat dhe të mbrohen nga mëkatet. Njashtu është mbrojtës për agjëruesin.

- “Qëkur erdhi në Medine, i Dërguari ﷺ asnjëherë nuk ka agjëruar tërë muajin, përveçse muajin ramazan.” Siç përmendet në fillim të hadithit i Dërguari ﷺ ka agjëruar kohë të gjatë pa ndërprerje në disa muaj jashtë Ramazanit, si p.sh. në muajin Muharram dhe Sha’ban. Megjithatë i Dërguari ﷺ nuk e ka agjëruar asnjë muaj tjetër të tërin përveç Ramazanit.

Këtu e ka veçuar periudhën medinase sepse në Medine janë shtuar dispozitat dhe kanë ardhur njëra pas tjetrës.

Hadithi 103

Aishja, radijallahu anha, thotë: “I Dërguari i Allahut ﷺ kujdesej për agjërimin e ditës së hënë dhe të enjtes.” (Transmetojnë Tirmidhi, Nesai dhe ibn Maxhe)

Transmetuesja

Aishe radijAllau anha: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

I Dërguari ﷺ i kushtonte rëndësi kësaj veprë, mendohej ti agjërojë ditën e hënë dhe të enjte. Urtësia në këtë vepër është përmendur në hadithin e Ebu Hurejres në vijim.

Hadithi 104

Ebu Hurejre, radijallahu anhu, transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Shfaqen veprat (e njerëzve) të hënë dhe të enjten, prandaj dëshiroj që veprat e mia të shfaqen duke qenë agjërueshëm.” (Transmeton Tirmidhi)

Transmetuesi:

Ebu Hurejre: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

I Dërguari ﷺ agjëronte ditën e hënë dhe të enjte, sepse veprat e njeriut i shfaqen Allahut në këto dy ditë dhe i Dërguari ﷺ dëshironte të jetë në gjendjen më të lartë të devotshmërisë.

Veprat e natës i shfaqen Allahut para se të bëhet ditë, veprat e ditës i shfaqen para se të bëhet natë, veprat e javës i shfaqen në ditën e hënë dhe të enjte, ndërsa veprat e një viti i shfaqen në muajin Sha’ban, në të cilin i Dërguari ﷺ e shtonte agjërimin.

Hadithi 105

Ebu Salihu tha: E pyeta Aishen dhe Ummu Seleme, radijallahu anhuma: Cilat vepra ishin më të dashura për të Dërguarin ﷺ? Thanë: “Ajo që është e vazhdueshme edhe nëse është e paktë.” (Transmeton Tirmidhi)

Transmetueset:

Aishe dhe Ummu Seleme radijAllahu anhuma: Janë cekur më herët.

Shpjegimi:

Veprat që kryhen vazhdimisht janë veprat më të dashura për Allahun dhe për të Dërguarin ﷺ edhe nëse janë të pakta. Ky parim vlen për veprat nafile (vullnetare). I Dërguari ﷺ thotë: “Bëni ato vepra (vullnetare) që keni mundësi, me të vërtetë Allahut nuk i vjen mërzi derisa juve t’iu vijë mërzi”.

Pra edhe në agjërim nafile muslimani nëse dëshiron që vepra e tij të jetë e dashur tek Allahu, agjëron aq sa ka mundësi të agjërojë vazhdimisht.

SI LEXONTE KURAN I DËRGUARI ﷺ**Hadithi 106**

Katadeja, rahimehullah, thotë: E kam pyetur Enesin, radijallahu anhu, për leximin e të Dërguarit ﷺ, tha: “E zgjaste.” (Transmetojnë Buhari, Ebu Davud, Nesai dhe ibn Maxhe)

Transmetuesi:

Enesi radijallahu anhu: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

- “E zgjaste.” I Dërguari ﷺ e zgjaste leximin e Kuranit aty ku kishte nevojë të zgjatet, sipas rregullave të texhuidit.

Hadithi 107

Ummu Seleme, radijallahu anha, thotë: “I Dërguari i Allahut ﷺ ndërpriste leximin. Thoshte: *EL-HAMDULIL-LAHI RABBIL-ALEMIN*, e do të ndalej. Pastaj thoshte: *ERRAHMANIR- RAHIM*, e do të ndalej dhe lexonte *MALIKI JEUMID-DIN*.” (Transmetojnë Tirmidhi, Ebu Davud dhe Nesai)

Transmetuesi:

Ummu Seleme: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

- “I Dërguari i Allahut ﷺ ndërpriste leximin.” Domethënë i Dërguari ﷺ i ndante ajetet, ndalej pas leximit të secilit ajet, pastaj vazhdonte me ajetin e radhës.

Urtësia e të lexuarit në këtë mënyrë e bën lexuesin dhe dëgjuesin që të kuptojë ajetet më mirë dhe ndihmon në meditimin rreth tyre.

TË QAJTURIT GJATË LEXIMIT TË KURANIT**Hadithi 108**

Abdullah ibn Shikhiri, radijallahu anhu, thotë: “Erdha tek i Dërguari i Allahut ﷺ ndërsa ai falej. Prej të qarit, nga gjoksi i dëgjohej fërshëllimë ashtu siç vlon vorba.” (Transmeton Ebu Davud)

Transmetuesi:

Abdullah ibn Shikhiri: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

Ibnul Kajjimi thotë: “Qarja e të Dërguarit ﷺ ishte e të njëjtit lloj sikurse të qeshurit e tij, nuk ishte vajtim me zë të lartë ashtu siç nuk ka qenë të qeshurit e tij me zë të lartë. Iu mbushnin sytë dhe lotët i rridhnin rrëke, i dëgjohej fërshëllimë nga gjoksi.

Të qarit e të Dërguarit ﷺ ndonjëherë ishte për shkak të mëshirës që kishte për të vdekurin, ndonjëherë për shkak të frikës dhe dhembshurisë për ummetin e vet, ndonjëherë nga frika e Allahut dhe ndonjëherë gjatë dëgjimit të Kuranit. E ky lloj e të qarit është prej mallëngjimit, dashurisë dhe madhështisë, i shoqëruar me frikë dhe drojë...”

Hadithi 109

Abdullah ibn Mes’udi, radijallahu anhu, thotë: Më tha i Dërguari i Allahut ﷺ: “*Më lexo.*” I thash: Si të të lexoj, o i Dërguari i Allahut, ndërsa ty të është zbritur? Tha: “*Unë dua ta dëgjoj prej dikujt tjetër.*” Lexova suren En-Nisa derisa arrita tek ajeti “*...e ty do të sjellim dëshmitarë mbi ata (që nuk besuan)?*” (En-Nisa: 41), i pashë sytë e të Dërguarit të Allahut ﷺ të lotonin.” (Transmetojnë Buhari, Muslim, Ebu Davud, Tirmidhi dhe Nesai)

Transmetuesi:

Abdullah ibn Mes’ud: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

- “*Unë dua ta dëgjoj prej dikujt tjetër.*” I Dërguari ﷺ e ka dëgjuar Kuranin prej Xhibrilit alejhis-selam dhe ndonjëherë prej disa sahabëve dhe kjo gjë ishte e dashur për të. Njeriu ndonjëherë ndikohet nga leximi i Kuranit kur e lexon vet dhe ndonjëherë kur e dëgjon nga të tjerët.

- Lexova suren En-Nisa derisa arrita tek ajeti “*...e ty do të sjellim dëshmitarë mbi ata (që nuk besuan)?*” (En-Nisa: 41), i pashë sytë e të Dërguarit të Allahut ﷺ të lotonin.” Allahu në Ditën e Gjykimit çdo të dërguar do ta sjellë dëshmitar për popullin (ummetin) në të cilin ishte dërguar. Dhe kjo është prej drejtësisë

së përsosur të Allahut. I Dërguari ﷺ është dëshmitar i këtij ummeti. Abdullah ibn Mes'udi kur lexoi këtë ajet i Dërguari ﷺ u ndikua dhe filluan ti lotonin sytë e tij fisnik prej të qarit.

SHTRATI

Hadithi 110

Aishja, radijallahu anha, thotë: “*Shtrati i të Dërguarit të Allahut ﷺ ku flinte ishte nga lëkura e regjur e mbushur me fije të palmës.*” (Transmetojnë Muslim, Tirmidhi, Ebu Davud dhe ibn Maxhe)

Transmetuesja:

Aishe radijAllau anha: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

Nëna e besimtarëve Aishja radijAllahu anha kur e përshkruante shtratin e thjeshtë në të cilin pushonte i Dërguarit ﷺ thotë: “إنما” (innemaa) që nënkupton “vetëmse”, që d.m.th. se shtrati i të Dërguarit sal-lAllahu alejhui ue sel-lem ishte vetëm një lëkurë e regjur e mbushur me fije të drurit të hurmës. Nga kjo nëkuptojmë se preokupimi i muslimanit nuk duhet të jetë rehatia e jetës së kësaj bote, por preokupimi dhe gajlja e tij duhet të jetë fitimi i kënaqësisë së Allahut subhanehu ue teala dhe Xhennetit të Tij të përjetshëm.

MODESTIA

Hadithi 111

Omer ibn Hattabi radijAllahu anhu transmeton se i Dërguari ﷺ ka thënë: “*Mos më lartësoni tej mase, ashtu si krishterët e lartësuan Isain, birin e Merjemes, sepse unë jam vetëm se një rob, prandaj thoni: Rob i Allahut dhe i Dërguar i Tij.*” (Transmetojnë Buhari dhe Ahmed)

Transmetuesi:

Omer ibn Hattabi: Ebu Hafs El-Kurashij. Prijësi i besimtarëve pas Ebu Bekr es-Siddikut radijAllahu anhu. Një prej dhjetë sahabëve të përgëzuar me Xhennet. E ka pranuar Islamin në vitin e gjashtë të hixhretit. Ka rënë dëshmor në vitin njëzet e tre të hixhretit duke qenë prijës i besimtarëve.

Shpjegimi:

Modestia është sjellja e mirë, largimi nga kryelartësia me njerëzit tjerë dhe mos konsiderimi i vetes mbi tjerët.

Modestia e të Dërguarit ﷺ vërehej qartë në moralin dhe sjelljen e tij me njerëzit.

- “Mos më lartësoni tej mase, ashtu si krishterët e lartësuan Isain, birin e Merjemes...” I Dërguari ﷺ e përdor fjalën “الإطراء” (El-Itraau) që do të thotë: Kalimi i kufirit në lavdërim dhe ngritje. Krishterët e tepruan me Isain alejhissalam ku disa e konsideruan si Zot e disa të tjerë biri i Zotit (I Lartësuar qoftë Allahu nga ajo që thanë zullumqarët që e tepruan).

Përkundër kësaj ndalese, disa njerëz e tepruan dhe arriti çështja tek ata derisa i përshkruan të Dërguarit ﷺ disa cilësi dhe të drejta të cilat nuk i takojnë askujt tjetër përveç Allahut subhanehu ue teala. Kjo gjë ndodh në sektet e devijuara që e teprojnë në ngritjen e të Dërguarve dhe eulijave. Ata merren me teprime në ngritjen e të Dërguarit ﷺ dhe në lavdërimin e tij, me lavdërime të cilat nuk i takojnë askujt përpos Allahut dhe nuk i kushtojnë rëndësi pasimit dhe ndjekjes së të Dërguarit ﷺ.

- “... sepse unë jam vetëm se një rob, prandaj thoni: Rob i Allahut dhe i Dërguar i Tij.” Detyra jonë është të jemi të kënaqur me zgjedhjen e të Dërguarit të Allahut ﷺ dhe kjo është prej plotësimit të dashurisë ndaj tij.

- “...Rob i Allahut...” Robi nuk adhurohet dhe nuk i përshkruhet gjë prej veçorive të Zotit dhe as prej të drejtave të Tij, sado që e lartë të jetë pozita e tij.

- “... dhe i Dërguar i Tij.” E drejta e të Dërguarit ﷺ është të pasohet, të ndiqet, të ecet në rrugën e tij dhe të gjurmohet pas udhëzimeve të tij.

Fjalja “Rob i Allahut dhe i Dërguar i Tij” e largon robin nga dy skajet e devijuara: teprimi në mbivlerësim dhe nënvlerësim i të Dërguarit ﷺ. Me këtë rob realizon mesatarinë e kërkuar. Largimi nga mbivlerësimi realizohet duke besuar se Muhamedi ﷺ është rob i Allahut dhe largimi nga nënvlerësimi realizohet duke besuar se Muhamedi ﷺ është i Dërguari i Allahut.

Hadithi 112

Enes ibn Maliku, radijallahu anhu, thotë: *“I Dërguari i Allahut ﷺ bëri Haxhin mbi një samar të vjetruar, barte një pelerinë të leshtë e cila nuk vlente as katër dërhëmë. Thoshte: O Allahu im, bëje këtë Haxh pa rija (sy e faqe) e as sum’a (dëshirë për famë).”* (Transmetojnë Buhari dhe ibn Maxhe)

Transmetuesi:

Enes ibn Malik: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

- *“I Dërguari i Allahut ﷺ bëri Haxhin mbi një samar të vjetruar, barte një pelerinë të leshtë e cila nuk vlente as katër dërhëmë.”* Në këtë hadith kuptojmë modestinë e të Dërguarit ﷺ nga mjetet e udhëtimit dhe veshja e tij e thjeshtë.
- *Thoshte: O Allahu im, bëje këtë Haxh pa rija (sy e faqe) e as sum’a (dëshirë për famë).”* I Dërguari ﷺ e luste Allahun që ti jep sinqeritet në vepra, sepse Allahu nuk i pranon veprat përveç atyre që bëhen për hir të Tij. Kush i bën ortak(shirk) Allahut në adhurime Allahu e braktis atë dhe shirkun e tij. Prandaj, besimtari duhet ta luftojë veten e tij për tu larguar nga punët që bëhen për sy e faqe dhe ata që bëhen për famë.

Hadithi 113

Enes ibn Maliku, radijallahu anhu, tregon: *“Nuk kishte njeri më të dashur për ta (sahabët) se i Dërguari i Allahut ﷺ. Tha: Kur e shihnin askush prej tyre nuk i çohet në këmbë, sepse e dinin se ai e urrente atë gjë.”* (Transmeton Buhari në Edebul-Mufred, Tirmidhi dhe Ebu Shejh)

Transmetuesi

Enes ibn Malik: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

- *“Nuk kishte njeri më të dashur për ta (sahabët) se i Dërguari i Allahut ﷺ.”* Këtu kuptohet pozita e të Dërguarit ﷺ që e kishte në zemrat e sahabëve. Ata e

donin të Dërguarin ﷺ më shumë se vetveten e tyre, se pasurit e tyre dhe se krejt njerëzit.

- “Kur e shihnin askush prej tyre nuk i çohesh në këmbë, sepse e dinin se ai e urrente atë gjë.” Sepse dashuria ndaj tij ﷺ kërkon që ti bindesh, të duash atë që e do ai, e jo me pretendim se e do të Dërguarin e Allahut ﷺ dhe ta kundërshtosh urdhrin e tij, dëshirën e tij dhe atë që e do ai.

Hadithi 114

Na njoftoi Jahja ibn Ebi Hejthem El Attari duke thënë: “E kam dëgjuar Jusuf ibn Abdullah ibn Selam, radijallahu anhum, se ka thënë”: “I Dërguari i Allahut ﷺ më emërtoi Jusuf, më uli në prehrin e tij dhe ma ledhatoi kokën.” (Transmeton Ahmed)

Transmetuesi:

Jusuf ibn Abdullah ibn Selami. Ka ndërruar jetë në hilafetin e Omer ibn Abdulazizit.

Shpjegimi:

- “I Dërguari i Allahut ﷺ më emërtoi Jusuf...” Kur lindi ky sahabi e sollën tek i Dërguari ﷺ dhe Ai ﷺ e emërtoi Jusuf.
- “...më uli në prehrin e tij dhe ma ledhatoi kokën.” Ledhatimi i kokës tregon përkëdhelje dhe afirim ndaj të voglit. Dhe kjo është prej modestisë së të Dërguarit ﷺ ngase ai i afronte të vegjlit dhe i ulte në prehrin e tij.

Hadithi 115

Aishja, radijallahu anha, është pyetur: “Ç’bënte i Dërguari ﷺ në shtëpinë e tij? Tha: Ishte njeri i rëndomtë, pastronte rrobat e tij, milte delen dhe përkujdesej për vetveten.” (Transmetojnë Buhari dhe Tirmidhi)

Transmetuesja

Aishe radijAllau anha: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

Kur është pyetur Aishja radijAllahu anha për punët e të Dërguarit ﷺ në shtëpi ka thënë: *“Ishte njeri i rëndomtë”* kjo është parapërgatitje për atë që do vijë nga përgjigjja e nënës së besimtarëve. D.m.th. ai ﷺ nuk e dallonte veten prej njerëzve.

“...pastronte rrobat e tij, milte delen dhe përkujdesej për vetveten.” I pastronte, i qepte, i arnonte dhe i përgatiste rrobat e veta për përdorim. Me duart e tij milte delen. Shërbente vetveten, kur kishte nevojë për diçka çohëj dhe vetë e kryente punën duke mos i urdhëruar të tjerët. Të gjitha këto tregojnë për modestinë e kompletuar të të Dërguarit ﷺ.

MORALI**Hadithi 116**

Enes ibn Maliku, radijallahu anhu, thotë: *“I shërbeva Resulullahut ﷺ dhjetë vite dhe asnjëherë nuk më tha as “of” dhe nuk më tha për diçka që e veprova pse e veprova kështu, apo për diçka që e lash pse nuk e bëre. I Dërguari ﷺ ishte njeriu me moral më të lartë. Dora ime nuk ka prekur khaz e as mëndafsh, por edhe asgjë tjetër më të butë se sa dora e të Dërguarit ﷺ. Asnjëherë nuk kam nuhatur misk e as parfum më të mirë sesa djersa e tij ﷺ.”* (Transmetojnë Buhari, Muslim, Tirmidhi dhe Ebu Davud)

Transmetuesi:

Enes ibn Malik: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

Morali përfshinë edukatën e brendshme të njeriut, si durimin, turpin, zemërgjerësinë dhe edukatën e tij të dukshme si sjelljen e mirë me të tjerët, fjalën e drejtë, buzëqeshjen etj.

Morali ndahet në moral të lartë dhe moral të ulët. Morali i lartë është zbukurimi i moralit virtyte të larta dhe të jetuarit me to, duke e kontrolluar egon (nefsin) dhe duke i braktisur veprat dhe cilësitë e shëmtuara. Ndërsa moral i ulët është e kundërta e kësaj.

Morali i të Dërguarit ﷺ është morali më i përkryer, më i mirë dhe më i pastër. Për këtë dëshmon fjala e Allahut subhanehu ue teala:

“Vërtet, ti je në një shkallë të lartë morali!” (El-Kalem-4)

Morali i tij ﷺ ishte Kurani. Nuk do gjesh në Kuran ndonjë vlerë morale, edukatë, sjellje të mire, ftesë për ndonjë vlerë dhe ndalesë nga ndonjë gjë të ulët, vetëm se i Dërguari ﷺ është cilësuar me të në mënyrën më të përkryer.

• *“I shërbeva Resulullahut ﷺ dhjetë vite dhe asnjëherë nuk më tha as “of”. Kjo gjë tregon për moralin e lartë dhe të përkryer të Dërguarit ﷺ, sepse dhjetë vite janë një kohë e mjaftueshme për shpalosur të metat morale, ose për të ndodhur gjërat të cilat e dëmtojnë moralin e lartë. Një gjë e tillë nuk ka ndodhur në sjelljen e të Dërguarit ﷺ me Enesin radijAllahu anhu.*

Prandaj Enesi radijAllahu anhu në lidhje me moralin e të Dërguarit ﷺ thotë: *“Ishte njeriu me moral më të lartë.”*

Ky hadith njëkohësisht tregon për përpikërinë e Enesit radijAllahu anhu në obligimet fetare, sepse Enesi nëse do kishte mangësi në këtë aspekt i Dërguari ﷺ nuk do kishte heshtur por do ti thoshte: Pse e bërë këtë ose pse se bërë!

Hadithi 117

Aishja, radijallahu anha, thotë: *“I Dërguari i Allahut, nuk ishte gojëndyrë, as që bëhej i tillë, e as që bërtiste nëpër tregje. Të keqen nuk e kthente me të keqe, por falte dhe ishte shpirtgjerë.”* (Transmeton Tirmidhi)

Transmetuesja

Aishe radijAllau anha: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

• *“...nuk ishte gojëndyrë, as që bëhej i tillë,”* Të qenët vulgar assesi nuk ishte nga udhëzimi dhe morali i tij, nuk ishte gojëndyrë e as që vepronte si i tillë.

• *“Të keqen nuk e kthente me të keqe, por falte dhe ishte shpirtgjerë.”* Kur i është bërë ndonjë e keqe nuk e kthente me të keqe edhe pse lejohet të kthehet me të njëjtën masë. Allahu i Madhëruar thotë: ***“Ndëshkimi i të keqes, bëhet në të njëjtën masë,”*** (Es-Shura:40) por ajo që është më e mirë dhe e lëvdueshme është atë që e ka bërë i Dërguari i Allahut ﷺ, falja dhe pajtimi.

Allahu thotë në vazhdimin e ajetit të lartpërmendur: ***“...e kush fal e bën pajtim, shpërblimi i tij është te Allahu.”***

Hadithi 118

Aishja, radijallahu anha, thotë: “*I Dërguari i Allahut ﷺ asnjëherë nuk ka goditur dikë me dorën e tij, përveç kur luftonte në rrugë të Allahut, e as nuk goditi shërbëtorë e as grua.*” (Transmetojnë Muslim dhe Ahmedi)

Transmetuesja:

Aishe radijAllau anha: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

I Dërguari ﷺ gabimet nuk i trajtonte me goditje, por i edukoi sahabët me një edukatë të lartë. Nuk u sillte me njerëzit me gjëra që ata i urrejnë. Kur nuk i pëlqente diçka të Dërguarit ﷺ i ndryshonte çehrja dhe sahabët e kuptonin se Ai ﷺ e urren atë gjë. Ky është edukimi më i mire.

Hadithi 119

Aishja, radijallahu anha, tregon se: “*I Dërguari i Allahut ﷺ i pranonte dhuratat dhe shpërblente për to.*” (Transmetojnë Buhari, Ebu Davud, Tirmidhi dhe Ahmedi)

Transmetuesja:

Aishe radijAllau anha: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

I Dërguari ﷺ i pranonte dhuratat dhe nuk i refuzonte asnjëherë sado e thjeshtë të ketë qenë dhurata. Pranimi i dhuratave është nga bujaria dhe pjesë e moralit të lartë me të cilën bashkohen zemrat dhe shtohet dashuria mes njerëzve.

I Dërguari ﷺ shpërblente dhuruesin me ndonjë gjë sa vlera e dhuratës ose me diçka më shumë se vlera e dhuratës.

TURPI

Hadithi 120

Ebu Se'id Khudriu, radijallahu anhu, thotë: *“I Dërguari ﷺ ishte më i turpshëm se virgjëresha pas perdes së saj, kur diçka nuk i pëlqente, atë e vërenim në çehren e tij.”* (Transmetojnë Buhari, Muslim dhe ibn Maxhe)

Transmetuesja

Ebu Se'id Khudri: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

Turpi është një virtyt i lartë dhe është pjesë e imanit. Në transmetimin e Imam Buhariut i Dërguari ﷺ thotë: *“Turpi është prej imanit”*. I tërë turpi është mirësi, sepse nxit në vepra të mira, në adhurime, sjellje të mira dhe edukatë. Njashtu largon nga punët e këqija prej haramëve, mëkateve dhe moralit të ulët. Turpi është virtyt që shpie në zbukurimin e vlerave të larta dhe largon nga veset e ulëta.

- *“...ishte më i turpshëm se virgjëresha pas perdes së saj ...”* Ebu Seid el-Khudri radijAllahu anhu për të përshkruar turpin e përsosur të të Dërguarit ﷺ e përmend shembullin e virgjëreshës e cila është vajza e re në moshën e martesës dhe është e njohur me turpin e saj.
- *“...kur diçka nuk i pëlqente, atë e vërenim në çehren e tij.”* Me këtë moral të lartë të të Dërguarit të Allahut ﷻ u edukuan sahabet pranë tij. Ai ﷺ nuk kishte nevojë ti qortonte e as ti ndalonte, sahabët vërenin fytyrën e ndershme të tij ﷺ dhe nëse shihnin hidhërim e kuptonin se e urren atë gjë, përmirësoheshin dhe braktisnin atë vepër.

HIXHAMEJA E TË DËRGUARIT ﷺ

Hadithi 121

Aliu, radijallahu anhu, tregon se i Dërguari i Allahut ﷺ ka bërë hixhame dhe e ka urdhëruar Aliun që ta paguan haxhxhamin. (Transmeton ibn Maxhe)

Transmetuesi:

Aliu radijAllahu anhu: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

Hixhameja është mjekim i dobishëm, i Dërguari ﷺ bënte hixhame, udhëzoi për diç të tillë dhe lajmëroi se në bërjen e hixhames ka shërim me lejen e Allahut.

Hixhameja bëhet duke e pre lëkurën me brisk ose mjet të ngjashëm, duke bërë në lëkurë prerje të vogla që nuk janë të thella dhe më pas nxjerrja (tërheqja) e gjakut nga trupi me ndihmën e një ene si gotë ku edhe mbushet gjaku.

Në hadithin e ibn Abbasit i Dërguari ﷺ thotë: “*Shërimi është në tre gjëra: në sherbetin e mjaltit, në hixhame dhe në kauterizim, por unë e ndaloj umetin tim nga kauterizimi*”. (Buhariu – 5680)

- “*...i Dërguari i Allahut ﷺ ka bërë hixhame dhe e ka urdhëruar Aliun që ta paguan haxhxhamin.*” Në këtë hadith kuptojmë se i Dërguari ﷺ ka bërë hixhame dhe e ka paguar haxhxhamin. Haxhxham quhet person i cili ua bën të tjerëve mjekimin e hixhames. Dhe kuptojmë nga hadithi se lejohet të bëhet pagesë dhe të merret pagesë për hixhamen.

Kërkimi i shërimit është urdhër i fesë së Allahut të Madhëruar dhe nuk e kundërshton mbështetjen në Allahun i cili është Shërues. i Dërguari i Allahut ﷺ thotë: “*Mjekohuni o robër të Allahut! Allahu subhanehu nuk ka vendosur sëmundje vetëmse ka vendosur bashkë me të edhe shërim, përveç vdekjes.*” (Ibnu Maxheh-3436)

Hadithi 122

Enesi, radijallahu anhu, thotë: “I Dërguari ﷺ bënte hixhamen në dy damarët e qafës dhe në pjesën e epërme në mes të shpinës, bënte hixhame ditën e

shtatëmbëdhjetë, nëntëmbëdhjetë dhe ditën e njëzet e një.” (Transmeton Tirmidhi dhe ibn Maxhe)

Transmetuesi:

Enes ibn Malik: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

- “*I Dërguari ﷺ bënte hixhamen në dy damarët e qafës dhe në pjesën e epërme në mes të shpinës,*” Këto pjesë të trupit që përmenden në hadith janë pjesët më të dobishme për bërjen e hixhames. Këtë e vërtetojnë edhe hulumtimet mjekësore të kohës së sodit.
- “*...bënte hixhame ditën e shtatëmbëdhjetë, nëntëmbëdhjetë dhe ditën e njëzet e një.*” Në këto ditë të muajit hënor shtohet gjaku dhe qarkullon më shumë, prandaj është koha më e përshtatshme për bërjen e hixhames.

EMRAT E TË DËRGUARIT ﷺ

Hadithi 123

Xhubejr ibn Mut’imi, radijallahu anhu, transmeton se i Dërguari ﷺ ka thënë: “*Unë kam emra, unë jam Muhamedi, unë jam Ahmedi, unë El-Mahi me të cilin Allahu fshin mosbesimin, unë jam El-Hashir tek këmbët e së cilit do të tubohen njerëzit ditën kur do të qëndrojnë para Allahut dhe unë jam El-Akib pas të cilit nuk ka më të dërguar.*” (Transmetojnë Buhari, Muslim dhe Tirmidhi)

Transmetuesi:

Xhubejr ibn Mut’im ibn Adij El-Kurashij 59h.

Shpjegimi:

I Dërguari ﷺ posedon shumë emra, të cilat nuk janë thjeshtë vetëm emra, por janë emra që përmbajnë kuptime dhe kanë domethënie, njashtu këto emra janë edhe cilësi të tij ﷺ.

- “...unë jam Muhamedi...” Me këtë emër e ka emërtuar gjyshi i tij me inspirim nga Allahu që të jetë i lavdëruar në këtë botë dhe botën tjetër. Kuptimi i Muhamedit ﷺ është Ai i cili posedon cilësi të larta, të mira dhe virtyte të bujarisë me të cilat lavdërohet.

Prej ngjarjeve interesante është se idhujtarët kur e shanin dhe i thoshin fjalë fyese të Dërguarit ﷺ nuk e emërtonin Muhamed por thoshin: *Mudhemmem* që do të thotë: i urryer, i qortuar. Transmeton Ebu Hurejre se i Dërguari ﷺ thotë: “A nuk u vjen çudi (habi) se si i shmang Allahu nga unë sharjet e Kurejshitëve dhe mallkimet e tyre? Ata shajnë Mudhemmemin, mallkojnë Mudhemmemin, ndërsa unë jam Muhamedi”. (Buhariu-3533)

- “...unë jam Ahmedi...” Ai që e lavdëron Allahun më së shumti dhe këtë e bën në mënyrën më të mirë.

MOSHA E TË DËRGUARIT

Hadithi 124

Ibn Abbasi, radijallahu anhu, thotë: “I Dërguarit ﷺ qëndroi në Mekke trembëdhjetë vjet ku i zbriste shpallja dhe dhjetë në Medine. Vdiq kur i pati gjashtëdhjetë e tre vjet.” (Transmetojnë Buhari, Muslim dhe Tirmidhi)

Transmetuesi:

ibn Abbasi, radijallahu anhu: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

Në hadith përmenden periudhat e jetës së të Dërguarit ﷺ. Ai ﷺ jetoi në Mekke dyzet vjet para se ti zbriste shpallja, u dërgua kur i mbushi dyzet vjet, pastaj siç thotë Abdullah ibn Abbasi radijAllahu anhuma: “I Dërguarit ﷺ qëndroi në Mekke trembëdhjetë vjet ku i zbriste shpallja dhe dhjetë në Medine. Vdiq kur i pati gjashtëdhjetë e tre vjet.”

Hadithi 125

Muavije, radijallahu anhu, thotë: *“I Dërguari i Allahut ﷺ vdiq kur i kishte gjashtëdhjetë e tre vjet, poashtu Ebu Bekri dhe Omeri, radijallahu anhum. Edhe unë i kam gjashtëdhjetë e tre vjet.”* (Transmeton Muslim)

Transmetuesi:

Muavije ibn Ebi Sufjan, radijallahu anhum 60h.

VDEKJA E TË DËRGUARIT ﷺ

Hadithi 126

Enes ibn Maliku, radijallahu anhu, tregon: *“Për herë të fundit e pashë të Dërguarin e Allahut ﷺ kur të hënën e zbuloi perden. Shikova fytyrën e tij e cila shkëlqente sikur fleta e mus’hafit. Njerëzit ishin të radhitur pas Ebu Bekrit, e ai me dorë u dha shenjë njerëzve të qëndrojnë. Ebu Bekri u printe në namaz, pastaj ai ﷺ e lëshoi perden. I Dërguari i Allahut ﷺ vdiq kah fundi i asaj dite.”* (Transmetojnë Buhari, Muslim, Nesai dhe ibn Maxhe)

Transmetuesi:

Enesi radijAllahu anhu: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

Vdekja e të Dërguarit të Allahut ﷺ e pikëllon çdo zemër që ka besim në Allahun dhe në të Dërguarin e tij ﷺ. Fatkeqësia më e madhe që e ka goditur njerëzimin është dhe do të jetë vdekja e të Dërguarit të Allahut ﷺ.

Sahabet radijAllahu anhum në momentet e para nuk e përballuan dot lajmin e vdekjes së të Dërguarit ﷺ, madje Omeri radijAllahu anhu tha: *“Kush thotë se i Dërguari i Allahut ﷺ ka vdekur e godas me shpatë”*. Por Allahu xhel-le xhelaluhu i përforcoi zemrat e besimtarëve me Ebu Bekr Es-Siddikun radijAllahu anhu siç do të ceket në vijim inshaAllah.

- *“Për herë të fundit e pashë të Dërguarin e Allahut ﷺ kur të hënën e zbuloi perden.”* I Dërguari ﷺ ndërroi jetë ditën e hënë paradite (në kohë të Duhasë).

Njerëzit e falën namazin e sabahut të asaj dite pas Ebu Bekr Es-Siddikut radijAllahu anhu.

Gjendja e të Dërguarit të Allahut ﷺ ishte përkeqësuar prej sëmundjes, e zbuloi perden, i shikoi sahabët dhe i pa të renditur në safe për namaz, të përkushtuar për Allahun dhe të përlur para Tij. I Dërguari ﷺ kur i pa sahabet në këtë gjendje buzëqeshi siç është transmetuar në Sahihun e Muslimit: “...pastaj buzëqeshi i Dërguari ﷺ” prej lumturisë dhe gëzimit të madh.

Allahu subhanehu ue tealë e gëzoi të Dërguarin e tij ﷺ dhe ia ndriçoi sytë me këtë pamje të gëzueshme të fundit kur e shikoi ummetin e tij të tubuar në xhami për të falur namazin.

• “*Shikova fytyrën e tij e cila shkëlqente sikur fleta e mus’hafit.*” Enesi radijAllahu anhu e shikoi të Dërguarin ﷺ në atë moment dhe e cilësoi me këtë cilësi. Pra fytyra e tij ﷺ e ndershme ishte e dëlirë, e ndriçuar, e bukur.

Nuk ishte rasti i vetëm që tregon rëndësinë e namazit në ditët e fundit të jetës së të Dërguarit ﷺ. Aliu, Enesi dhe Ummu Seleme radijAllahu anhum transmetojnë se porosinë dhe fjalët e fundit të Dërguarit ﷺ ishin: “*Namazi, namazi dhe ata që i keni nën posedimin tuaj.*”

Këtu kuptojmë vlerën dhe rëndësinë e namazit në fenë e Allahut.

• “*Njerëzit ishin të radhitur pas Ebu Bekrit, e ai me dorë u dha shenjë njerëzve të qëndrojnë*” Kur buzëqeshi i Dërguari ﷺ, sahabet u gëzuan shumë, u emocionuan duke menduar se i Dërguari ﷺ do të del në xhami që t’iu prijë në namaz, por i Dërguari ﷺ u dha shenjë që të qëndrojnë dhe të vazhdojnë namazin me Ebu Bekrin radijAllahu anhu.

• “*...pastaj ai ﷺ e lëshoi perden. I Dërguari i Allahut ﷺ vdiq kah fundi i asaj dite.*” I Dërguari ﷺ e lëshoi perden dhe qëndroi në shtëpinë e tij derisa ia dorëzoi shpirtin Allahut pas lindjes së diellit në kohë të duhasë me konsensus të dijetarëve të sires.

Ndërsa fjala e Enesit radijAllahu anhu “...vdiq kah fundi i asaj dite...” Ndoshta është thënë për vërtetimin e lajmit të vdekjes së të Dërguarit ﷺ. Sepse sahabët në fillim të ditës u tronditën me këtë lajm të hidhur dhe nuk e besonin dot prej pikëllimit të madh.

Allahu i qetësoi zemrat e besimtarëve me fjalimin e Ebu Bekr Es-Siddikut radijaAllahu anhu. Ai lexoi dy ajete: “***Ti do të jesh i vdekur, e edhe ata do të jenë të vdekur.***” (Zumer-30) dhe ajetin “***Muhamedi nuk është tjetër vetëm se i dërguar. Edhe përpara tij pati të dërguar. E nëse ai vdes ose mbytet, a do të ktheheshit ju prapa? E kushdo që kthehet prapa, ai nuk i bën dëm Allahut aspak, kurse Allahu do t’i shpërblejë mirënjohësit.***” (Ali Imran-144)

Pastaj tha fjalën e madhe: “*Kush e adhuron Allahun, me të vërtetë Allahu është i gjallë nuk vdes kurrë dhe kush e adhuron Muhamedin, me të vërtetë*

Muhamedi ka vdekur”. Pas fjalimit të Ebu Bekrit radijAllahu anhu, sahabët u qetësuan dhe e besuan lajmin edhe pse pikëllimi ishte i madh.

Hadithi 127

Aishja, radijallahu anha, thotë: “*I Dërguari ﷺ ishte i mbështetur për gjoksin tim, ose në prehrin tim. Pastaj kërkoi një enë për të urinuar në të. Urinoi e pas kësaj vdiq.*” (Transmeton Nesai)

Transmetuesja:

Aishe radijAllahu anha: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

- “*I Dërguari ﷺ ishte i mbështetur për gjoksin tim...*” Sëmundja e rëndë e të Dërguarit ﷺ filloi ditën e hënë një javë para se të ndërrojë jetë dhe mori leje prej bashkëshorteve të tij që të qëndroj në shtëpinë e Aishes radijAllahu anha dhe ato i dhanë leje. I Dërguari ﷺ pas një jave ndërroi jetë duke qenë i mbështetur në gjoksin e Aishes radijAllahu anha.
- “*...kërkoi një enë...*” Për shkak të sëmundjes së rëndë nuk kishte mundësi të lëviz shumë, prandaj kërkoi enë për të urinuar.

Hadithi 128

Aishja, radijallahu anha, thotë: “*Nuk shpresoj vdekje të lehtë, pasi që i pashë mundimet e vdekjes së të Dërguarit të Allahut ﷺ.*” (Transmetojnë Tirmidhi dhe Nesai)

Transmetuesja:

Aishe radijAllahu anha: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

Aishja radijAllahu anha nuk shpresonte vdekje të lehtë pasi që e pa se çfarë mundimesh përjetoi rob i mirë i Allahut.

Arsyeja e mundimeve të rënda të vdekjes që i përjetoi i Dërguari ﷺ janë si shkak i shpërblimit të dyfishtë që do ti jepet atij ﷺ.

Buhariu rahimehullah transmeton nga Abdullah ibn Mesudit radijAllahu anhumu se Ai ka thënë: “Erdha tek i Dërguari i Allahut ﷺ në sëmundjen e tij dhe ai vuante prej mundimeve të rënda. Thash: Ti po vuan rëndë. Thash: A ndodh kjo ndodh sepse ke shpërblim të dyfishtë? Tha ﷺ: Po, çdo musliman që e godet një e keqe, Allahu bën që ti bien (shlyen) gabimet, ashtu siç bien gjethet e drurit.”

Hadithi 129

Aishja, radijallahu anha, thotë: “Pasi që vdiq i Dërguari i Allahut ﷺ erdhi Ebu Bekri, e puthi mes dy syve, vendosi duart mbi krahët tij ﷺ dhe tha: - Ah për Pejgamberin! Ah për të zgjedhurin! Ah, për shokun e jetës!” (Transmeton Tirmidhi në Shemail)

Transmetuesja:

Aishe radijAllahu anha: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

Ky hadith është argument se i vdekuri mund të puthet në ballë si përshëndetje lamtumirëse. Ebu Bekri radijAllahu anhu, shoku më i afërt i Dërguarit ﷺ shpreh pikëllimin me disa fjalë dhe e puth në ballë të Dërguarin e Allahut ﷺ.

Hadithi 130

Aishja, radijallahu anha, thotë: “I Dërguari i Allahut ﷺ vdiq ditën e hënë.” (Transmeton Buhari)

Transmetuesja:

Aishje radijAllahu anha: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

Aishja radijAllahu anha tregon qartësisht ditën në të cilën ka vdekur i Dërguari i Allahut ﷺ. Njashtu edhe lindja e tij ishte ditën e hënë.

Hadithi 131

Enes ibn Maliku, radijallahu anhu, thotë: “Kur i Dërguari ﷺ i ndjeu mundimet e vdekjes, Fatimeja, radijallahu anha, tha: - Ah, për vuajtjet e tij! I Dërguari ﷺ i tha asaj: Prej sot babai yt më nuk do të ndjejë mundime. Babait tënd i ka ardhur ajo që do ta lë askënd, takimi është në Ditën e Gjykimit.” (Transmetojnë Buhari, Nesai dhe ibn Maxhe)

Transmetuesi:

Enesi radijAllahu anhu: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

• “Prej sot babai yt më nuk do të ndjejë mundime.” Sepse vuajtjet e robërve të mire mbarojnë me mbarimin e kësaj jete. Pastaj në Ahiret kanë shpërblim të madh dhe të përhershëm tek Allahu.

I Dërguari i Allahut ﷺ e ka qetësuar vajzën e tij Fatimen radijAllahu anha me tri gjëra;

- Prej asaj dite ai më nuk do të ndjejë mundime.
- Vdekja do ti vijë gjithkujt.
- Takimi në Ditën e Gjykimit do të jetë me të mira e gëzime me lejen e Allahut.

TRASHËGIMIA E TË DËRGUARIT ﷺ

Hadithi 132

Amër ibn Harithi, radijallahu anhu, thotë: “Nuk la i Dërguari i Allahut ﷺ pas vetes vetëm se armën e tij, mushkën dhe tokën të cilën e la lëmshë.” (Transmetojnë Buhari dhe Nesai)

Transmetuesi:

Amër ibn Harithi, vëllai i Xhujrijes bashkëshortes së të Dërguarit ﷺ. Ka ndërruar jetë rreth vitit 50h.

Shpjegimi:

Hadithi tregon se ajo çka ka lënë i Dërguari ﷺ pas vetes ka qenë një pasuri shumë e vogël, që mund të numërohet me gishtat e dorës.

Thotë ibn Kethiri (Allahu e mëshiroftë): “Kjo botë me të gjithë çka ka në të ishte pa vlerë për të Dërguarin ﷺ ashtu siç është pa vlerë për Allahun, andaj i Dërguari ﷺ nuk ka përpiquej për të fituar pasuri apo të lë pas vetes trashëgimi...”

Hadithi 133

Aishja, radijallahu anha, transmeton se i Dërguari ﷺ ka thënë: “*Ne (të dërguarit) nuk trashëgohe mi. Atë që lëmë, është lëmoshë.*” (Transmetojnë Buhari dhe Muslim)

Transmetuesja

Aishja radijAllahu anha: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

Aishja radijAllahu anha e transmetoi këtë hadith edhe pse ishte prej trashëgimtarëve të të Dërguarit ﷺ, në rast se dikush do e trashëgonte të Dërguarin ﷺ, gjë që tregon sinqeritetin dhe drejtësinë e Aishes radijAllahu anha. Por prej veçorive të të dërguarve të Allahut alejhim es-salam është që mos i trashëgojë askush.

Hadithi 134

Ebu Hurejre, radijallahu anhu, thotë: I Dërguari ﷺ tha: “*Trashëguesit e mi nuk do të ndajnë as dinar e as dërrhem. Ajo që mbetet pas furnizimit për gratë e mia dhe punëtorët e mi, është lëmoshë.*” (Transmetojnë Buhari, Muslim dhe Ebu Davud)

Transmetuesi:

Ebu Hurejre radijAllahu anhu: Është cekur më herët.

Shpjegimi:

- “...punëtorët e mi...” Ibn Haxheri ka thënë se më këtë fjalë synohet prijësi i besimtarëve pas tij ﷺ.

و صلى الله و سلم على نبينا محمد و على آل محمد و آخر دعوانا أن الحمد لله رب العالمين